

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7725 E premte 30 Nëntor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Para disa ditësh në Pejë ndodhi diçka që nuk kisha dashur të isha bashkëkohës i saj: një gënjeshtër monumentale, e pashembullt dhe e papërsëritshme ...
Vijon në faqen 20

Nga MEHMET KRAJA
Bashkim apo aneksim i Kosovës nga Shqipëria?


Opinion *i* **Ditës**
Tri ngjarje të publikuara në javët e fundit, në dukje pa lidhje në Ballkanin Perëndimor janë shfaqur si argumentet më të fundit për një tezë që e kam ...
Vijon në faqen 21

Nga JASMIN MUJANOVIC
BE dhe SHBA po nxisin kaos në Ballkan




Katër fëmijë ia dalin me 150 mijë lekë

Historia e dhimbshme e një 16-vjeçareje: Si është të jetosh në kabinën elektrike

Intervista/ Ina Çoniku: Kemi frikë, ka patur raste kur kemi luftuar me flakët

VOLTIZA DURO

Edhe këtë vit, ata do t'i kalojnë netët e gjata të dimrit plot ankth, mbështjellë nën batanijet e ftohta. Të rrethuar nga muret plot lagështirë, katër fëmijët e familjes Çoniku në fshatin Çeravë të Pogradecit duhet të jetojnë ...

Në faqen 9

BILANCI TRAGJIK/ VRASJE NGA POLICIA, VDEKJE NE BURG DHE AKSIDENTE

6 SHQIPTARE TE VDEKUR PER 10 DITE NE GREQI

Policia greke qëllon për vdekje mbi Altin Mullën: Gjetëm 2 kallashnikovë dhe 10 thasë me drogë. Një 35-vjeçar gjendet pa jetë në qelitë e Trikallës



(Në foto) Forca policie duke ushtruar kontroll ndaj shtetasve grek dhe mjeteve te tyre ne doganen e Kakavijes.

VOTIMI

Parlamenti Europian: Të hapen negociatat e BE me Shqipërinë në muajin qershor

Në faqet 2-3

PLAGOSJA E POLICES

26 ditë protestë tek Unaza, 18-vjeçari që hodhi kapsollën kërkon falje

Në faqen 4

KRITERET

Emigrantët në Greqi, ja sa vite pune duhen që të merret pensioni

Në faqen 8

KRIMI

Bilanci i luftës, 80 raste vrasjesh e zhdukjesh në 3 vite në Vlorë

Në faqen 7

"INSTITUCION I MBYLLUR"



Çudia, artisti i dërgon një plumb të vërtetë në zarr 'Galerisë së Arteve'

Në faqen 18

RRREFIMI/ Presidenti: "Mësuesi" im, Dritëroi. Pakti detar? Zbatoj Kushtetutën

Meta: Raportet e mia me Ramën, Berishën e Nanon

"Me ish-kryetarin e PD-së kam marrëdhënie të veçantë, ka kimi tjetër"

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka sqaruar dje në emisionin "Opinion" të gazetarit Blendi Fevziu, raportet e tij me kryeministrin Rama, kreun e opozitës Basha si edhe me ish-kryeministrin Berisha. Nga të tre, ra në sy fakti se Meta ka veçuar marrëdhënien e tij me Ber-



ishën pasi siç edhe u shpreh: "Marrëdhëniet e mia me z. Berisha janë marrëdhënie të veçanta. Është një kimi tjetër", - ka deklaruar Meta. Meta u shpreh se me ardhjen e tij në krye të Presidencës dhe axhendat e ndryshme me bashkëshorten kjo ...

Në faqet 12-13

INTEGRIMI RAPORTI

Valentina Madani

Parlamenti European, Këshilli i Ministrave dhe Komisioni European u kërkojnë liderëve politikë në Shqipëri që të kapërcejnë mosmarrëveshjet e brendshme dhe të bashkohen forcat për integrimin european. Rezoluta për Shqipërinë bën thirrje për dialog politik mes palëve dhe kthimin e opozitës në parlament. "PE inkurajon të gjitha forcat politike që të bëjnë përpjekje të mëtejshme për të krijuar një dialog të mirëfillt politik dhe për të arritur bashkëpunim konstruktiv, duke mbështetur kështu procesin e reformave. Rithekson besimin e tij të fortë se dialogu politik duhet të zhvillohet brenda institucioneve demokratike, është shumë i shqetësuar për bojkotin de facto të procesit parlamentar nga opozita pas pushimit veror të vitit 2018", shprehet Parlamenti European. Një vëmendje të veçantë, rezoluta ia kushton reformës zgjedhore, duke inkurajuar punën e bërë deri më tani nga komisioni "ad hoc". "PE kërkon adresimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR. Nënvizon se nevojitet një reformë gjithëpërfshirëse dhe në kohë, me qëllim rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor. Kujton nevojën për t'u kushtuar vëmendje të duhur pretendimeve për financim të paligjshëm dhe të padeklaruar të partive politike, mirëpret punën e Komitetit "ad hoc" për Reformën Zgjedhore lidhur me pavarësinë dhe depolitizimin e administratës zgjedhore, transparencën në financimin e fushatës, regjistrimin e votuesve, blerjen e votave, përdorimin e teknologjive të reja të votimit dhe votimin jashtë vendit dhe i kërkon Parlamentit të Shqipërisë që të arrijë konsensus dhe të miratojë reformat e nevojshme në kohën e duhur para zgjedhjeve vendore të vitit 2019". Vijimi i reformës në drejtësi mbetet kyc, ndërkohë që kërkohet avancimi i procesit të vetingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ndërkohë, Parlamenti European pret ngritjen e institucioneve të reja të drejtësisë: "PE u bën thirrje autoriteteve shqiptare që sa më parë të përfundojnë krijimin e organeve të reja gjyqësore dhe të kthejnë në gjendje funksionale Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë. PE thekson nevojën për të përfunduar themelimin e Byrosë Kombëtare të Hetimit, të Gjykatës Speciale dhe të Prokurorisë Speciale Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar". Për të nënvizuar rëndësinë që i jep luftës kundër krimin të organizuar, raporti i Parla-

Dokumenti për Shqipërinë: Rrisni financimet për hetimet, finalizoni reformën në drejtësi

PE, thirrje për dialog: Reformat, me një parlament konstruktiv

"Opozita debatin ta zhvillojë në Kuvend"



KËRKESAT

Raporti kërkon ngritjen e institucioneve të reja të pavarura në arkitekturën e re të drejtësisë, si edhe rezultate të mëtejshme në luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit para hapjes së negociatave të qershor të 2019-ës. Reportuesi Fleckenstein ka përfshirë gjithashtu edhe nevojën për kryerjen e reformës zgjedhore para zgjedhjeve lokale të 2019-ës.



Parlamenti European

RAPORTI, REKOMANDIMET E BRUKSELIT PËR SHQIPËRINË

- Mbështesim plotësisht rekomandimin e komisionit që të hapen negociatat e pranimit për Shqipërinë në qershor të 2019. Inkurajojmë Shqipërinë për të ruajtur ritmin e zbatimit të reformave. Mirëpresim miratimin e Kodit të Sjelljes së Parlamentit Shqiptar, i cili do të rrisë integritetin dhe transparencën e procesit parlamentar dhe besimin e publikut.
- Kërkojmë zbatimin e rekomandimeve të OSBE/ODIHR për zgjedhjet. Nevojitet një reformë zgjedhore gjithëpërfshirëse dhe në kohë, me qëllim rritjen e besimit të publikut në procesin zgjedhor. Reforma zgjedhore të adresojë pretendimet për financime të paligjshme të padeklaruar të partive politike.
- Mirëpresim punën e Komitetit Ad-hoc për Reformën Zgjedhore të Parlamentit Shqiptar lidhur me pavarësinë dhe depolitizimin e administratës zgjedhore, transparencën në financimin e fushatës, regjistrimin e votuesve, përdorimin e teknologjive të reja të votimit dhe votimin e emigrantëve. Reforma të miratohet me konsensus dhe në kohën e duhur para zgjedhjeve vendore të 2019. Kandidatët me probleme penale të përjashtohen nga lista dhe nivelet e qeverisjes.
- Lufta kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, si dhe zbatimi i të drejtave pronësore varen nga suksesi i procesit i zbatimit të reformës gjyqësore. Kërkojmë nga autoritetet shqiptare që sa më parë të përfundojnë krijimin e organeve të reja gjyqësore dhe të kthehen në funksion Gjykatat Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë.
- Shqetësim mbetet mosgjatja e gjuhës së konsensusit nga klasa politike shqiptare për miratimin e ligjeve të tjera të reformës në drejtësi.
- Ritheksojmë besimin e plotë se dialogu politik duhet të zhvillohet brenda institucioneve demokratike. Jemi të shumë të shqetësuar për bojkotin e procesit parlamentar nga opozita.
- Përsërisim përpjekjet e bëra në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, në veçanti arrestimet e anëtarëve të grupit kriminal të Bajri dhe kërkime që të vazhdojnë më tej me rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme.
- Shqipëria të forcojë masat për të shkatërruar dhe ndaluar burimet financuese për terrorizmin dhe të merret seriozisht me radikalizmin që përhapet 'online' përmes internetit.

"Kaçifas", Parlamenti Evropian, kërkesë Shqipërisë për hetime

Parlamenti Evropian risolli në vëmendje dje edhe vdekjen e Konstantinos Kaçifas, për të cilin ka bërë thirrje për një hetim të plotë. Propozimi për hetim u paraqiti nga deputeti grek i PASOK, Nikos Androulakis dhe socialdemokratit gjerman, Knut Fleckenstein dhe i mbështetur në mënyrë dërmuese nga Parlamenti Evropian, shkruan "Kathimerini". Amendimi u shtua në një raport të PE-së, lidhur me bisedimet e pranimit midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian. Amendamenti u bën thirrje autoriteteve shqiptare të hetojnë dhe të përcaktojnë rrethanat që çuan në vdekjen e Kaçifasit. 35-vjeçari u qëllua më 28 tetor, ditën e festës kombëtare të Greqisë, pas përplasjes me armë zjarri midis tij dhe policisë. Mediat greke



Konstantinos Kaçifas

raportuan pas vrasjes së 35-vjeçari i lindur në Bularat dhe banues në Athinë rezultonte person me precedentet penalë në Greqi. Mësohet se ai është arrestuar në vitin 2009 nga policia greke në Halandri, në periferi të Athinës, pasi është kapur me rreth 1 kilogram hashash. Prokuroria në Athinë e ka akuzuar 35-vjeçarin në vitin 2009 për akuzën e trafikut të drogës, si dhe si pjesëtar të

një organizate kriminale. Por me gjithë këtë, në ditën e ceremonisë së varrimit, qindra shtetas grekë dhe ekstremistë mbërritën në Bularat duke "vajtur" shqiptarin me kombësi greke, me thirrje e parulla nacionaliste dhe duke nxirur urrjet. Për këtë arsye, Shqipëria shpalli "non grata" 52 shtetas grekë, mes tyre dhe eurodeputetën qipriotë, Eleni Theocarus.

mentit European flet me emra të përveçëm: "Përsëritet përparimin e bërë në luftën kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, në veçanti arrestimet e fundit të anëtarëve të grupit kriminal Bajri dhe kërkon

që të vazhdohet më tej me rezultate të prekshme dhe të qëndrueshme, përfshirë në fushën specifike të luftimit të kultivimit dhe trafikimit të drogës". Raporti i Parlamentit European vlerëson përpjekjet e Sh-

qipërisë, ndaj i kërkon Komisionit dhe Këshillit European që të hapë negociatat me Tiranën, ndërsa sugjeron mbajtjen brenda vitit të ardhshëm të tryezës së parë ndër-institucionale BE-Shqipëri.

Komisioneri Hahn apelon për uljen e tensioneve në rajon

Komisioneri për politikën e fqinjësisë dhe negociatave të anëtarësimit, Johannes Hahn apeloj për uljen e tensioneve në rajon, lidhur me marrëdhëniet midis Prishtinës dhe Beogradit. I pranishëm me herët gjatë diskutimeve, komisioneri për zgjerimin Johannes Hahn, u ndal dje veçanërisht në gjendjen e rajonit, duke u shprehur se Ballkani duhet të vijojë të mbetet lart në axhendën politike të BE-së. Sipas tij, është mjaft e rëndësishme që të dërgohet deri në fund marrëveshja për çështjen e emrit me Kosovës dhe Serbisë si dhe akordi për emrin me Athinës dhe Shkupit. "Të gjithë duhet të kenë për qëllim që të qetësojnë situatën, kryesisht atë lidhur me marrëdhëniet midis Kosovës dhe Serbisë. Nuk ka alternativë tjetër përveçse dialogun dhe normalizimin. Është në interesin e rajonit dhe perspektivës rajonale. Të gjithë duhet të tërhiqen nga deklaratat që mund të shihen si ndezëse ose të njëanshme", theksoi z.Hahn. Gjatë seancës u miratuan gjithashtu edhe rezolutat për Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë.



Parlamenti Evropian voton pro integritimit të Shqipërisë, kundër raportit 112 vota

PE mbështet negociatat, Fleckenstein: Kryeni reformën zgjedhore

"Tirana të përmbushë detyrat e shtëpisë"

Valentina Madani

Parlamenti Evropian mbështet idenë e hapjes së negociatave për Shqipërinë në verën e vitit 2019, ndërsa rezoluta e hartuar nga raporteri Knut Fleckenstein mori dje 459 vota pro, 112 kundër dhe 62 abstenime. Dokumenti i hartuar nga eurodeputeti vë në dukje progresin e vendit tonë në fushat prioritare, por nënvizon gjithashtu rëndësinë e mbajtjes së kësaj ecurie pozitive, e sidomos në reformën në drejtësi si dhe luftën kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit. Brukseli pranon se Shqipëria ka bërë progres në rrugën e integritimit evropian, por institucionet e pavarura në arkitekturën e re të drejtësisë duhet të jenë funksionale dhe lufta kundër kimit të organizuar dhe korrupsionit duhet të vijohet me rezultate të mëtejshme konkrete. Ky është mesazhi që dhanë 3 institucionet kyçe europiane gjatë debatit në seancën plenare të Parlamentit Evropian mbi progresin e integritimit evropian të Shqipërisë në 2018. Në prezantimin e raportit gjatë debatit, Fleckenstein deklaroi se tashmë Këshilli i Bashkimit Evropian duhet të mbajë fjalën e dhënë në qershor dhe duhet të miratojë çeljen e procesit negociator për anëtarësimin e Shqipërisë. Megjithatë, porositi e tij nuk munguan as për Tiranën zyrtare, ku kërkohet që të përmbushen detyrat e shtëpisë. Ngritja e institucioneve të reja të drejtësisë mbetet për BE-në një çështje thelbësore. Kjo rezolutë përhëndet progresin që është bërë nga Shqipëria, në kuadër të 5 prioritetëve kyçe të përcaktuar nga Komisioni Evropian për hapjen e negociatave të anëtarësimi të vendit. Rezoluta nënvizon veçanërisht fillimin e procesit të vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, vetingu, duke e konsideruar si fryt të parë të domosdoshmë të zbatimit të reformës në drejtësi.

REFORMAT

Në raportin e përgatitur nga Knut Fleckenstein me 48 pika dhe që mori aprovimin e eurodeputetëve njihen përpjekjet e Shqipërisë për re-



Raporteri Knut Fleckenstein

MIRATIMI

Parlamenti Evropian votoi dje raportin e eurodeputetit Knut Fleckenstein për integritimin e Shqipërisë. Ky raport u miratua me 459 vota pro, 112 kundër dhe 62 abstenime.

LSI: Problem mbetet reforma zgjedhore

Gjoshja: Çështja është si të largojmë shitblerjet e votave

Deputetja e LSI-së, Klajda Gjoshja, e ftuar në rubrikën "Opinion", në "News 24" foli dje për procesin e integritimit të Shqipërisë drejt familjes së madhe të Bashkimit Evropian. Ajo përhëndeti miratimin nga PE të raportit për Shqipërinë, si një mundësi për hapjen e negociatave në qershor të 2019-ës. Ish-ministria e Integritimit theksoi se një ndër problemet bazë të Shqipërisë mbetet reforma zgjedhore, e cila ka pesë vite që pret në sirtarë dhe kjo sipas saj është një ndër pikat kyçe të anëtarësimi të drejt BE-së. "Parlamenti Evropian ka qenë mbështetës i Shqipërisë dhe i të gjithë Ballkanit. Unë e kam thënë se për ne negociatat janë jetike. Pavarësisht mesazheve pozitive që jep PE, nuk është se Shqipëria ka shkëlqyer në 5



Ditmir Bushati

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati, u shpreh mirënjohës për mbështetjen e PE në procesin e aderimit në BE. "Raporti pranon qartë përparimin e bërë në fushat që lidhen me sundimin e ligjit. Votimi i raportit është thirrje për fillimin e bisedimeve të pranimit në 2019-ën. Shqipëria është gati për faqen e re sfiduese të procesit të pranimit", shprehet z.Bushati.

detyrat kyçe. Unë sërisht e përgëzoj dhe në të gjitha fazat duhet të marrim përgjigje pozitive. Reforma zgjedhore ka mbi 5 vite që pret, sepse OSBE dhe rekomandimet e saj vijojnë të mbeten në sirtarë dhe askush nuk shikon për t'i miratuar. Opozita e ka dhënë votën e saj, tashmë është vullneti i mazhorancës për

të nisur në implementimin e saj. Është kollaj të thuash se faji është i opozitës", tha Gjoshja. Por sipas saj: "Çështja është se si ne duhet të largojmë shitblerjet e votave. Ne mund të shkojmë në Kuvend për ta votuar, e cila në radhë të parë duhet ta garantojë votën e qytetarit".

formën në drejtësi dhe progresin drejt finalizimit të hapjes së negociatave. Raportuesi për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, eurodeputeti gjerman, Knut Fleckenstein mbështet fuqishëm hapjen e negociatave me BE, por për "Deutsche Welle"-n, shprehet se "me keqardhje e shoh se kjo nuk është bërë dhe shpresoj shumë për një zhvillim pozitiv menjëherë pas zgjedhjeve europiane". I pyetur nëse zgjedhjet evropiane mund ta paralizojnë

procesin e integritimit të Ballkanit në BE, në rast të shtimit të forcave djathtë, Fleckenstein thekson: "Forcat e djathta, antieuropiane janë forcur ndjeshëm në vendet e Bashkimit Evropian. Kjo do të reflektohet me shumë gjasa edhe në përbërjen e parlamentit të ri. Por unë pres që edhe pas zgjedhjeve europiane të kemi një mazhorancë të qartë për politikën pro zgjerimit të BE-së". Për eurodeputetin gjerman, Knut Fleckenstein deri në atë

kohë, Shqipëria duhet të përgatitet dhe të zgjerojë procesin e reformave. Shprehimist Knut Fleckenstein përmend reformën zgjedhore që Shqipëria duhet ta kryejë. Por, edhe "një parlament konstruktiv dhe i besueshëm është i pazvendësueshëm jo vetëm përsa i përket procesit të reformave, por edhe si opozita dhe mazhoranca qeverisëse janë të thirrura që të përballen së bashku për këto sfida", theksoi Fleckenstein për "Deutsche Welle"-n.

Eurodeputeti



KNUT FLECKENSTEIN

"Një parlament konstruktiv dhe i besueshëm është i pazvendësueshëm jo vetëm përsa i përket procesit të reformave, por edhe si opozita dhe mazhoranca qeverisëse janë të thirrura që të përballen së bashku me këto sfida", theksoi eurodeputeti Fleckenstein.



Balla: PE mbështet plotësisht hapjen e negociatave në qershor

Kreu i grupit parlamentar socialist, Taulant Balla, përmes një postimi në "Twitter" i bëri jehonë votimit në PE, i cili miratoi dje me 459 vota pro dhe 112 kundër raportin për Shqipërinë. Ky i fundit, i përpiluar dhe prezantuar nga raporteri për Shqipërinë në Parlamentin Evropian, Knut Fleckenstein, mbështet plotësisht rekomandimin e Komisionit Evropian, shkruan Balla, për hapjen e negociatave për anëtarësim për Shqipërinë qershorin e ardhshëm, për shkak të njohjes së përpjekjeve për reformat e ndërmarrura. "Parlamenti Evropian ka votuar me 459 vota pro në favor të raportit të vitit 2018 për Shqipërinë. Ky raport mbështet plotësisht rekomandimet e Komisionit Evropian, që lejon hapjen e negociatave në njohje të përpjekjeve për zbatimin e reformave të bëra nga Shqipëria", shkruan Balla.

ANETARËSIMI

Knut Fleckenstein, mbështet plotësisht rekomandimin e Komisionit Evropian, shkruan Balla, për hapjen e negociatave për anëtarësim për Shqipërinë qershorin e ardhshëm, për shkak të njohjes së përpjekjeve për reformat e ndërmarrura.

UNAZA E MADHE PROJEKTI

Kryeministri akuzon kreun e PD se ka shpifur kundër tij

Paketa antishpifje, Rama depoziton 6 padi kundër Bashës dhe Berishës

Deri sa të miratojë pa ketën e masave kundër shpifjes, kreu i qeverisë ka vendosur të veprojë në bazë të legjislacionit aktual për të paditur kundërshtarët politikë për çdo deklaratë që ata bëjnë kundër tij dhe që ai i konsideron të pavërteta. Kështu, ashtu siç kishte bërë të ditur më parë, kryeministri Edi Rama ka vërsuar me një lumë padish në Gjykatën e Tiranës kundër kryetarit të PD-së, Lulzim Basha dhe ish-kryeministrit Sali Berisha. Gjatë muajit nëntor në Gjykatën e Tiranës janë depozituar gjashtë padi për shkaktrim dëmi, në të cilat si palë paditëse është kreu i qeverisë, Edi Rama. Sipas të dhënave zyrtare,



paditë e firmosura nga kryeministri i vendit janë kundër dy kundërshtarëve të tij politikë, Lulzim Basha dhe

Sali Berisha. Për kryeopozitarin Basha, kryeministri ka depozituar katër padi. Të gjitha ato janë për "shkaktrim dëmi". Sipas burimeve të "ABC Neës", në përmbajtjen e tyre Rama konsideron si shpifëse disa deklaratat publike të bërë nga kryetari i Partisë Demokratike. Ndërsa kundër ish-kryeministrit Sali Berisha, Rama ka dorëzuar dy padi në gjykatë. Por, kryeministri nuk është i vetëm përfaqësues i mazhorancës që ka depozituar padi për shpifje kundër opozitës. Kjo, pasi në

regjistrin e çështjeve në Gjykatën e Tiranës rezultojnë edhe padia e Taulant Ballës kundër deputetit demokrat Gent Strazimiri. Paditë në fjalë janë hedhur në short dhe regjistruar, ndërsa në ditët në vijim pritet të nisë edhe shqyrtimi i tyre. Sipas deklaratave të bëra nga Rama më parë, të gjitha paratë që do të fitohen nga gjyqet për shpifje do të shkojnë në Fondin e Edukimit, fond që do të mbështetë çerdhet dhe kopshtet.



Gjatë homazheve të djeshme në Varrezat e Dëshmorëve

Protestuesi: Nëse kalojnë mbi gjakun e fëmijëve të mi, do mund ta prishin shtëpinë

26 ditë protestë, banorët: Turp, po na arrestojnë familjarët

Banorët bllokuan sërish dje në mbrëmje rrugën

Banorët e zonës së "Astirit" që preken nga projekti i zgjerimit të Unazës së Madhe në segmentin nga Pallati me Shigjeta deri te Dogana kanë protestuar sërish dje për të 26 ditë resht. Të përkrahur edhe nga deputetët e opozitës, ata kanë dalë sërish në rrugë duke protestuar kundër përpjekjeve të qeverisë dhe bashkisë për t'i përçarë dhe për t'u prishur shtëpitë e tyre. Protestuesit janë shprehur të vendosur që të mos tërhiqen nga protesta e tyre, ndërsa kanë akuzuar bashkinë se po punon natën, duke hequr pemët dhe ndriçimin. Ata kanë kërkuar dje që policia të lirojë të gjithë të arrestuarit, ndërsa kanë deklaruar se as përpjekjet për t'i trembur ata nuk do të sjellin asnjë rezultat në shuarjen e protestës. Vëllai i një prej protestuesve të arrestuar, Kujtim Ylli u shpreh se do mbrojë me çdo formë banesën e tij dhe nuk do lejojë që ajo të prishet. "Më kanë arrestuar vëllain. Të mos bëjnë arrestime se është turp. Edhe 25 vite burg të bëj, ajo shtëpia ime kur të kalojë mbi gjakun e fëmijëve të mi, të 4 vëllezërve të mi dhe mbi trupit tim, atëherë do mund ta prishin. Po na mori shtëpinë, le të më marrin edhe nërin e gruas. Unë kam ardhur për të ardhmen e fëmijëve të mi këtu", - tha ai. Ndërsa, një tjetër banor i Unazës së Madhe dhe nga më aktivët në gjithë këto ditë protestë, Lutfi Kastrati, i cili u shpreh se shumica e protestuesve janë kundër bane-



Protesta e djeshme në Unazën e Re

save sociale që ofron bashkiak. "Jemi edhe kundër projektit, jemi kundër banesave sociale, nuk kemi nevojë për lëmshë. Projekti është shumë korruptiv, ka një megavjedhje në kurriz të banorëve të Unazës së Re", tha Kastrati.

DEPUTETËT

Protestën e banorëve mbrëmjen e djeshme e mbështetën edhe deputetët, Klevis Balliu dhe Silva

Caka, të cilët i kërkuar policisë të lirojnë të arrestuarit. "Policia e Shtetit ka nxjerrë fletë arrestin për Kujtim Yllin, një burrë të moshuar rreth 70 vjeç. Padrejtësisht e kanë lënë Kujtimin në qelitet e rajonit nr. 2. Këto arrestime bëhen vetëm për një arsye, për të trembur qytetarët e Unazës së Re, për t'u bërë presion atyre dhe familjarëve të tyre që të mos dalin të protestojnë për sh-

LUTFI KASTRATI

"Ne protestojmë dhe do mbrojmë deri në fund, çdo banor është kundër prishjes së shtëpisë së tij. Ne kundërshtojmë prishjen e banesave tona dhe bizneseve tona. Tani jemi dhe kundër projektit, jemi kundër banesave sociale, nuk kemi nevojë për lëmshë. Projekti është shumë korruptiv, ka një megavjedhje në kurriz të banorëve të Unazës së Re", tha Kastrati.

AKUZAT

Partia Demokratike ka

hedhur akuza ndaj kreut të ARSH-së, Afrim Qendro, por edhe ndaj kryeministrit Edi Rama për afëra korruptive që lidhen me projektin e Unazës së Re. Njëpërmjet ish-ministrit të Drejtësisë, Gazmend Bardhi, PD Bardhi tha dje se projekti 40 milionë euro është tenderuar pa studim fizibilitetit, pa vlerësim të ndikimit në mjedis, pa analizë kostoje/përfitimi, pa vlerësim shpronësimesh. Ndërkohë që nëpërmjet një njoftimi, Autoriteti Rrugor Shqiptar i kërkoi Bardhit të konsultohet me kryetarin e tij, Lulzim Basha, përpara se të dalë në një komunikim të tillë me median. "Nëse do kishite pyetur kryetarin e vet, z.Bardhi do ta kishte mësuar se në rastin e rehabilitimit të Unazës së Madhe në segmentin Pallati me Shigjeta - sheshi 'Shqiponja', Autoriteti Rrugor Shqiptar ka ndjekur të njëjtën praktikë ligjore që ka ndjekur Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për segmentet e tjera të Unazës në kohën kur z.Basha ishte Ministër i Punëve Publike e Transportit apo Kryetar i Bashkisë së Tiranës", thuhet në deklaratën e ARSH-së.



ARRESTIMET

Policia e Tiranës ka arrestuar dy protestues të zonës së "Astirit" në kryeqytet si dhe ka proceduar në gjendje të lirë 20 të tjerë. Në pranga kanë përfunduar Romeo Llulla dhe Kujtim Ylli, pasi akuzohen për tubim të paligjshëm, pengim të qarkullimit të mjeteve, shkatërrim të pronës dhe prishje të qetësisë publike. Lajmin e bëri dje të ditur vet policia nëpërmjet një njoftimi për mediat, ku theksoi se këta persona akuzoheshin lidhur me ngjarjet e mbrëmjes së të mërkurës.



DANIEL DOBRAJ

I riu që akuzohet se ka hedhur shakshën që plagosi efektin e policisë, Ina Nuku ka kërkuar dje falje, ndërsa ka deklaruar se kjo gjë nuk ka qenë e qëllimshme. "Jam dhunuar gjatë shoqërimit. Tani ndihem më mirë. Do të kërkoj falje publikisht nëse jo kapsollë që unë kam hedhur ka shkuar tek efektiva e policisë. Nëse kjo gjë ka ndodhur nuk ishte e qëllimshme, nuk ishte ajo që kërkohim ne. Ne nuk donim që të shkote kështu puna, që të dëmtohej efektiva"



Presidenti dhe kryeministri kanë bërë homazhe bashkë, por nuk janë takuar

Të majtët festojnë 29 Nëntorin, Meta dhe Rama shmangin njëri-tjetrin

Festime të vakëta për Ditën e Çlirimit

Edhe këtë vit politika ka festuar e ndarë 29 Nëntorin, ditën e Çlirimit të Shqipërisë nga regjimi nazi-fashist. Ashtu si edhe herët e tjera, opozita e djathtë nuk festoi, duke mos e njohur 29 Nëntorin si ditë çlirimi dhe duke e konsideruar atë si një ditë të errët për vendin, ndërsa të majtët ndonëse me dallime mes tyre, kanë kujtuar edhe këtë vit kontributin që dhanë mijëra shqiptarë që luftuan për çlirimin e vendit nga pushtuesit. E për t'i dhënë rëndësinë e duhur edhe këtë vit Protokollin i Shtetit kish-te organizuar një ceremoni solemne në Varrezat e Dëshmorëve. Të parët që mbërritën ishin veteranë luftë e të afërm të dëshmorëve të Atdheut, ndërsa në hyrje forcat e Gardës kishin marrë masat që mos të hynin brenda komunistët dhe ihtarët e diktatorit Enver Hoxha. Nga drejtuesit shtetëror mbërritën me radhë kreu i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj e pas tij kryetari i Kuvendit Gramoz Ruçi e Ilir Meta. Por që të fillonte ceremonia atyre u është dashur të presin pak minuta deri sa mbërriti edhe kryeministri, Edi Rama. Por edhe pse tashmë konsiderohet një krizë e tejkaluar mes presidentit dhe kryeministrit, u vu re sërisht se marrëdhëniet e tyre mbeten të ftohta. Meta nuk ia ka zgjatur dorën asnjërit prej tyre, duke shmangur kështu edhe takimin me Metën. Por kjo është vënë re më së miri nga kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi dhe kryebashkiaku Veliaj, madje ky i fundit për t'i nxjerrë të gjithë nga një situatë aspak e këndshme ka nxituar t'i ftojë ata që të vazhdojnë me ceremoninë, pasi tashmë gjerat ishin gati.



Gjatë homazheve të djeshme në Varrezat e Dëshmorëve

META
"Gëzuar 29 Nëntorin! Mirënjohje për të gjithë partizanët, heronjtë dhe dëshmorët e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, të cilët sakrifikuan gjithçka për çlirimin e Shqipërisë. Lavdi të përjetshme!", - uroi kreu i shtetit.

VOLTANA ADEMI
Shkodra nuk e ka festuar as zyrtarisht ditën e Çlirimit të vendit. Kjo pasi bashkia e drejtuar nga Voltana Ademi nuk kishte marrë asnjë masë organizative, ndërsa gjithë rrugët e qytetit ishin zbukuruar vetëm për 28 Nëntorin. Në një reagim për mediat ajo u shpreh: "Për Shkodrën 29 Nëntori është një ditë e zezë, mjafton t'i referoheni historianëve". Kjo nuk ka kaluar pa reagimin e kryeministrit, i cili duke iu referuar kësaj deklarate shkroi "Mirë lajthitën, po pse të tërë menjëherë vallë?"

EDMOND SPAHO
Kryetari i grupit demokrat, ndryshe nga PD, e ka njohur 29 nëntorin si ditën e çlirimit të vendit. Njëpërmjet një statusi në faqen e tij në "Facebook", Spaho ka urrear shqiptarët për festën. "Gëzuar Festën e Çlirimit të Shqipërisë. I përjetshëm kujtimi i të rënëve", - shkroi Spaho. Por ky urim nuk i ka pëlqyer demokratëve, të cilët kanë bërë një sërë reagimesh kundër Spahos.

Rikthimi i Mit'hat Frashërit, Komunistët: Qeveria "Rama" neoballiste

Nuk kanë munguar as këtë 29 Nëntor ihtarët e diktatorit Enver Hoxha. Me pankarta dhe fotografi të diktatorit në duar ata kanë pritur në hyrje të Varrezave të Dëshmorëve që të mbarojë ceremonia zyrtare dhe pas saj edhe ceremonia e organizuar nga LSI, për të vijuar më pas edhe ata me homazhe në nderim të kësaj dite. Ata vendosën një foto të madhe të Enverit para monumentit dhe më pas vijuan homazhet. E ndërsa ndarja me Partinë Demokratike të cilën e quajnë parti neofashiste është normale, këtë herë komunistët kishin diçka për t'i dhënë edhe qeverisë së socialiste të cilën e quajtën neoballist. "Në 14 nëntor 2018 populli shqiptar pa edhe dëgjoi ceremoninë për kthimin e eshtrave të Mit'hat Frashërit. Ky akt është shprehja e qartë e rehabilitimit të kolaboracionistit. Qeveria rilindase socialiste e Ramës është neoballiste dhe neokolaboracioniste. Poshtë qeveria neoballiste e Edi Ramës. Balli Kombëtar përfaqëson të interesat e borgjezisë. Balli Kombëtar zgjedhi bashkëpunimin me nazistët", tha kreu i Partisë Komuniste, Qemal Çiçollari.



Berisha: 29 Nëntori, datë e falsifikuar nga Enver Hoxha

Opozita nuk e njeh 29 Nëntorin si ditën e çlirimit të vendit dhe ish-kryeministri Sali Berisha në një reagim të tijin thotë se kjo datë është e falsifikuar nga Enver Hoxha me urdhër të Beogradit. Ai shkruan se rëndësia e këtij debati qëndron në faktin se Enver Hoxha falsifikoi edhe këtë datë, për ta njehsuar këtë festë jo me ditën e çlirimit, por me festën kombëtare të Federatës së Jugosllavisë, me ditën e shpalljes së saj në Jajcë, më 29 nëntor të vitit 1943. "Enver Hoxha falsifikoi edhe këtë datë, për ta njehsuar këtë festë jo me ditën e çlirimit, por me festën kombëtare të Federatës së Jugosllavisë, me ditën e shpalljes së saj në Jajcë, më 29 nëntor të vitit 1943. Pra, ai falsifikoi datën e çlirimit në mënyrë që, pas bashkimit si republikë e 7-të me Federatën Jugosllave, Shqipëria do të festonte edhe ajo më 29 nëntor së bashku me republikat e tjera, jo Jajcen, por Çlirimin e saj", - shkroi Berisha në koment të vet.

LSI ndryshe nga PD, respekton Ditën e Çlirimit

Menjëherë pas ceremonialisht zyrtar të organizuar nga Protokollin i Shtetit në Varrezat e Dëshmorëve mbërritën edhe përfaqësuesit e LSI-së, të cilët ndryshe nga demokratët e njohin 29 Nëntorin si ditën e çlirimit të vendit. Edhe ata kanë vendosur kurora me lule në monumentin "Nënë Shqipëri" ndërsa kanë kujtuar sakrificën që mijëra të rinj shqiptarë bënë duke dhënë edhe jetën në luftë për çlirimin e vendit nga nazi-fashistët. "Do doja që në emër të LSI-së nëpërmjet këtij ceremoniali ku vendosim kurora çdo vit, të respektojmë dhe të nderojmë dëshmorët e LANÇ dhe të gjithë ata djem dhe vajza



sakrifikuan jetën e tyre për ta renditur Shqipërinë si një vend fitues kundër luftës nazi-fashizmit. Nderimi për këta djem dhe vajza është më e pakta, pasi i dhanë çdo gjë Atdheut të tyre dhe s'i morën

asgjë. LSI do të nderojë ata pafundësisht, pasi ka pasur me qindra e mijëra djem dhe vajza që i kanë dhënë Shqipërisë dhe s'i kanë marrë asgjë", - tha Kryemadhi.

URIMET
"Gëzuar 29 Nëntorin! Mirënjohje për të gjithë partizanët, heronjtë dhe dëshmorët e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, të cilët sakrifikuan gjithçka për çlirimin e Shqipërisë. Lavdi të përjetshme!", uroi kreu i shtetit nëpërmjet "Facebook". Po ashtu edhe kryeministri u mjaftua vetëm me një mesazh të shkurtër po në rrjetet sociale. "Gëzuar Ditën e Çlirimit. Lavdi dëshmorëve të Atdheut", uroi shkurt Rama. Ndërkohë që ashtu si edhe para se të niste ceremoninë, edhe në largim Meta dhe Rama e kanë shmangur sërish shtrëngimin e duarve mes tyre, çka, në fakt, nuk ka munguar mes Metës dhe Ruçit, duke konfirmuar edhe një herë marrëdhëniet shumë të mira që ekzistojnë mes tyre.

titit nëpërmjet "Facebook". Po ashtu edhe kryeministri u mjaftua vetëm me një mesazh të shkurtër po në rrjetet sociale. "Gëzuar Ditën e Çlirimit. Lavdi dëshmorëve të Atdheut", uroi shkurt Rama. Ndërkohë që ashtu si edhe para se të niste ceremoninë, edhe në largim Meta dhe Rama e kanë shmangur sërish shtrëngimin e duarve mes tyre, çka, në fakt, nuk ka munguar mes Metës dhe Ruçit, duke konfirmuar edhe një herë marrëdhëniet shumë të mira që ekzistojnë mes tyre.

nia, edhe në largim Meta dhe Rama e kanë shmangur sërish shtrëngimin e duarve mes tyre, çka, në fakt, nuk ka munguar mes Metës dhe Ruçit, duke konfirmuar edhe një herë marrëdhëniet shumë të mira që ekzistojnë mes tyre.

Disa nga viktimat u vranë, ndërsa të tjerët vdiqën në aksidente

"Nëntori i përgjakur", në 10 ditë humbën jetën 6 shqiptarë në Greqi

GREQI

Dy javët e fundit të nëntorit kanë qenë tragjike sa u përket shqiptarëve në Greqi. Në harkun kohor të 10 ditëve, 6 qytetarë shqiptarë kanë humbur jetën në shtetin fqinj, disa prej të cilëve të vrarë, e të tjerë që janë ndarë nga jeta aksidentalisht. Më 19 nëntor, adoleshenti shqiptar Enriko Buzani, 15 vjeç, humbi jetën tragjikisht në një aksident automobilistik në qytetin Kyparissia. Ai kishte marrë pa leje makinën e të atit dhe së bashku me të ishin edhe dy shokë të tij 15-vjeçarë. Makina me të cilën udhëtonin tre shokët u përplas me një kamion që drejtohej nga një shtetas bullgar, i cili ka pësuar dëmtime të lehta. Nga përplasia e fortë humbën jetën menjëherë adoleshentët grek e bullgar, kurse 15-vjeçari shqiptar u dërgua në gjendje kritike në spitalin e Rio të Patras, por ndërroi jetë më vonë. Më 22 nëntor, Altin Mulla vritet në kufi pranë Pogonit nga policia greke. Së bashku me disa persona të tjerë, Mulla kishte kaluar ilegalisht nga kufiri i gjelbër për të trafikuar lëndë narkotike. Ata u diktuan nga policia greke, që patrolonte kufirin dhe nisën të qëllonin me armë. Nga shkëmbimi i zjarrit, Altin Mulla mbeti i vdekur, kurse shqiptarët e tjerë u arratisën.



Viktima Artan Mulla

Aksioni vazhdon për të arrestuar personat e tjerë të përfshirë në këtë ngjarje, dyshohet 4 të tillë. Ndërkohë, policia greke ka sekuestruar 10 thasë me drogë. Po kështu, në vendngjarje u gjetën edhe 2 kallashikovë. Më 24 nëntor, një 38-vjeçar shqiptar humbi jetën në aksident në hyrje të qytetit Malesina. Ai ishte duke udhëtuar i vetëm në makinë, kur humbi kontrollin e mjetit dhe doli nga rruga, duke përfunduar në oborrin e një shtëpie. Identiteti i viktimës nuk është bërë i ditur, por aksidenti ka qenë i

rëndë, aq sa është dashur ndërhyrja e zjarrfikësve për të nxjerrë nga makina trupin e shqiptarit. Një ambulancë e dërgoi 38-vjeçarin me urgjencë në spital, por fatkeqësisht ndërroi jetë sapo mbërriti. Shqiptari jetonte prej disa vitesh me familjen e tij në Greqi. Ndërkohë, policia greke ka nisur hetimet për të sqaruar tërësisht rrethanat e aksidentit me pasojë vdekjen. Më 25 nëntor, një i burgosur shqiptar në burgun e Trikallas u gjet i pajetë në qeli. Një natë më parë, gjendja shëndetësore e 35-vjeçarit

ishte normale kur kishte shkuar për të fjetur. Ai u gjet i vdekur nga gardianët, ndërsa shkaqet janë ende mister. Sipas mediave greke, autoritetet policore kanë nisur hetimet për të zbardhur shkaqet e vdekjes së shqiptarit.

Më 26 nëntor, një 63-vjeçar shqiptar u gjet i vdekur në një kanal në anë të rrugës në Korfuz. Nga hetimet para-prake, rezultoi se 63-vjeçari ishte qëlluar me çifte nga një distancë e afërt nga persona të panjohur. Më pas trupi i tij ishte hedhur në anë të rrugës. Shqiptari ishte person i njohur në atë zonë, pasi banonte prej vitesh. Fqinjët i thanë policisë se ai nuk kishte probleme me persona të tjerë. Më 29 nëntor, një 40-vjeçar shqiptar u përplas për vdekje nga një makinë në Selanik. Viktima po kalonte rrugën kur u godit nga një 20-vjeçar. Për shkak të plagëve, 40-vjeçari shqiptar humbi jetën menjëherë. Marrë nga 'tvklan.al'



Vrasja në ish-Blok, merret në pyetje këngëtarja Elvana Gjata

TIRANË - Këngëtarja e njohur Elvana Gjata ka dhënë dëshminë e saj në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, 56 ditë nga vrasja në zonën e ish-Blokut në kryeqytet. Burime për "News 24" dhe "GSI" bënë me dije se Gjata ka mbërritur në Rinas mbrëmjen e 22 nëntorit, në orën 00:30. Të njëjtat burime saktësuan se këngëtarja ka udhëtuar përmes linjës ajrore nga Vjena në Tiranë. Mësohet se këngëtarja Gjata ka dhënë dëshminë e saj para bluve mëngjesin e së premtes. Elvana Gjata u shpall në kërkim policor pas masakrës me një të vrarë e dy të plagosur në lokalit "Monopol", pasi për zbardhjen e ngjarjes nevojitej edhe dëshmia e saj. Në dosjen e Prokurorisë, e cila ngrinte të gjithë dinamikën e ngjarjes në zonën e ish-Blokut, thuhet se ditën e vrasjes Elvana Gjata është takuar me të fejuarin e saj jashtë lokalit "Monopol" për të shkëmbyer një çelës shtëpie. Dëshmi, të cilën këngëtarja Elvana Gjata besohet të ketë dhënë mëngjesin e 23 nëntorit pranë Drejtorisë së Policisë në Tiranë. Sakaq, burimet saktësuan se pas marrjes në pyetje, këngëtarja Elvana Gjata është lënë e lirë dhe mund të jetë larguar sërish nga Shqipëria. Ndërkohë, hetimet për ngjarjen në ish-Blok, në të cilën mbeti i vrarë 28-vjeçari Fabian Gaxha si edhe u plagosën, Ervis Martinaj dhe Eljo Hato kanë marrë një tjetër rrjedhë. Ato janë shtrirë në prishjen e pazareve të drogës mes të fejuarit të këngëtares, Ervin Matës si dhe një biznesmeni tjetër i shpallur në kërkim nga policia, Eldi Dizdari. Sipas informacioneve nga shërbimet partnere, rezultoi se Mata nuk i është përgjigjur Dizdarit për një ngarkesë të konsiderueshme droge. Ka qenë Dizdari që i ka thënë Matës se për borxhin duhet të sqarohet me Ervis Martinajn.

U sekuestruan 40 kg kanabis në makinë, kapet 23-vjeçari shqiptar, tjetri ikën me vrap

GREQI - Në vijim të luftës kundër trafikut të drogës nga Shqipëria janë zhvilluar dy operacione nga policia greke. Në kufirin e gjelbër në Kallpaq të Janinës, policia greke ka ndaluar një automjet, brenda të cilit u gjetën dhe sekuestruan 2 çanta që përmbanin 6 pako me 38 kg marijuanë. Gjatë operacionit është ndaluar vetëm drejtuesi i automjetit, 23-vjeçari shqiptar, ndërkohë që pasagjeri ka arritur të largohet me vrap. Në Selanik është kapur një bashkëpunëtor i tyre, 26-vjeçar grek. Ndërkohë në një operacion të dytë në Selanik janë sekuestruar 5 pako me 49.3 kg marijuanë dhe janë arrestuar dy shtetas grekë, teksa po fusnin drogë në një automjet. Që



Droga e sekuestruar në Greqi

prej fillimit të vitit e deri sot, në Igumenicë, Korfuz, Lefkadhja, Kefalonia, Janinë, Athinë, Selanik, Artë, Aitolokarnania, Patra, Ko-

stur, Grevena, Follorinë, Aleksandroupoli etj., policia greke ka sekuestruar rreth 10.7 tonë marijuanë që vinte nga Shqipëria.

Tirana International Airport
Nënë Tereza

TENDER OPPORTUNITY FOR DUTY FREE BUSINESS at TIRANA INTERNATIONAL AIRPORT SHPK (TIA)

Tirana International Airport (TIA) would like to inform the interested parties about the following tender opportunity at the Terminal Building, Departure Area. The airport is a transportation hub for Albania and it represents a unique and highly attractive location for all retailers and caterers with a double digit growth in passengers.

DUTY FREE

- Approx. 282 m²;

Prospective tenants are expected to meet the following requirements:

- Qualification and Experience with the object "Duty Free Management" (interested parties must provide examples / references); Information must be provided on similar current activities, number, size and location of outlets, years of operation, annual turnover in the last three years (or from the date of operation), total number of employees;
- Financial solidity, excellent standing and capability of the company; minimum relevant turnover in the last financial year of EUR 1,000,000 in the relevant field (interested parties must provide Profit & Loss statement of last three years);
- Relevant software/IT and data management experience concerning the Duty Free system used in the duty free areas managed by the company (interested parties must provide examples / references);
- To participate in this process interested parties will need to retrieve the Request for Proposal and sign the Confidentiality Commitment Document, which can be retrieved at Tirana International Airport, Administration Building, Rinas;
- Only to the companies that will submit the confidentiality commitment will be given the respective set of tender documents that contain the full information for submission of the proposals;
- The Request for Proposal will be distributed only on 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time, which, documents will be delivered in a CD, free of charge.

All inquiries and the Expression of Interest shall be addressed by hand or to all the following email address not later than 07 December 2018 up to 14:00 Eastern Time:

Tirana International Airport N'ne Tereza SH.P.K
Administration Building
Commercial & Property Department
Rinas, Albania

Emails:
Commercial Department
Legal Department
Procurement Department

Alisa Gjinarri
lir.alimema
Albi Palushi

agjinari@tirana-airport.com
ialimema@tirana-airport.com
apalushi@tirana-airport.com

Nga denoncimet e familjarëve, organet ligjzbatuese kanë evidentuar vetëm 4 raste

VLORË

Vlora është një ndër qytetet që po numëron viktimat e një beteje, që duket se është sunduar nga krimi i organizuar. Njëpër një dëshmi ekskluzive dhe dokumenteve të prokurorisë, "Top Story" zbërtheu një seri rrëmbimesh, të kryera për shkak të përplasjeve në trafikun e drogës. Rezultoni se numri i personave të raportuar të zhdukur, të humbur nga familjarët, nga viti 2015 deri tani ka pasur një numër rreth 80 referimesh", - thotë prokurorja Flora Çela. Nga denoncimet e familjarëve, organet ligjzbatuese kanë evidentuar vetëm katër raste për ekzistencën e veprave penale, atë të trafikimit të lëndëve narkotike dhe të rrëmbimit të personit. "Top Story" përmes përshkrimit dhe inskenimeve në terren solli në vëmendje disa histori e personazhe të zhdukur nga droga. Ndër to Albano Xhaferaj. Mëngjesin e 17 qershorit, Albano Xhaferaj u largua nga shtëpia, pa u ndarë me fëmijët dhe gruan, Danielën. Doli për një kafe me mikun e tij, Arbër Turja. Gruas i tha se do të kthehej shpejt në shtëpi. Albano sapo ishte kthyer nga Belgjika. Teksa konsumonin kafën, Albano merr një telefonatë dhe i kërkohej një takim i menjëhershëm. Pak minuta më vonë, një makinë tip "Audi", me targa AA560 TR ndalon në lokalitë e rrugës Transballkanike. Babai i dy fëmijëve hipën në të e më pas askush nuk e sheh më me sy. Daniela, duke menduar se bashkëshorti i saj ishte nën shoqërimin e miqve, nuk shqetësohet se Albano nuk u kthye në shtëpi. Gruan e re e zë paniku të nesërmen, kur telefoni i dilet i fikur. Për 7 ditë me radhë ka trokitur në çdo derë të miqve të bashkëshortit të saj, por asnjëri prej tyre nuk e kishte parë. Mëngjesin e 25 qershorit, ajo i është drejtuar komisarit të policisë së qarkut të Vlorës. Neglizhenca e treguar nga policia detyroi Lufti Xhaferajn, babai i 34-vjeçarit, të denonconte publikisht zhdukjen e Albanos. Një tjetër person i zhdukur nga droga në Vlorë është edhe Gazmend Merka, nëna e të cilit rrefeu gjatë emisionit telefonatën e fundit me të birin. "Para një jave e kishte marrë të vëllain në telefon, i thoshte mos dil se do të vrasin. Më thoshte dhe mua mos dil shumë, se do të vrasin edhe ty. Ata që kam ngrenë e kam pirë do më vrasin më tha", - rrefën nëna. Grupi e konsideronte Gazmentin një njeri të dobët, jo të besuarin e tyre, ndërsa ai, në një mbërmeje të fundit të korrikut i shikon nga dritarja që i vinin rrotull makinës së parkuar. 36-vjeçarin e zë paniku. Gazmenti dyshon se i kanë vendosur lëndë eksplozive, ndaj dhe lajmëron policinë. Pas kësaj ngjarjeje, më 1 gusht 2016, Gazmen-

Bilanc lufte në Vlorë, shënohen 80 raste zhdukjesh, rrëmbimesh e vrasjesh në 3 vite



Foto ilustruese

TRAFIKU I DROGËS

Njëpër një dëshmi ekskluzive dhe dokumenteve të prokurorisë, "Top Story" zbërtheu një seri rrëmbimesh të kryera për shkak të përplasjeve në trafikun e drogës. Rezultoni se numri i personave të raportuar të zhdukur, të humbur nga familjarët... nga viti 2015 deri tani ka pasur një numër rreth 80 referimesh", - thotë prokurorja Flora Çela.

ti është dorëzuar në komisaratin e policisë së Fierit. Officerëve të policisë ai u ka treguar se kishte dijeni mbi ngjarjet e fundit kriminale të ndodhura në Vlorë. 36-vjeçari u tha hetuesve se Albano Xhaferri ishte rrëmbyer dhe ekzekutuar me çekë në makinë dhe se ai i njihte autorët. Rrëmbimi bëhej për llogari të Edison Harizaj, sepse Albano kishte dijeni për atentatin që iu organizua Predinant Llanajt, ngjarje kjo e ndodhur në muajin tetor të vitit 2017. Gazmenti u ka rrefyer se ndihej i kërcënuar nga miqtë e tij, Ardian Kola, Aleksandër Çaushaj dhe Ilir Shakaj. Për këtë qëllim, sapo është kthyer nga Belgjika, Albano është ndjekur për një kohë të gjatë me makinën tip "Benz 250", ngjyrë e errët, në përdorim të shtetasit Aleksandër Çaushaj. Për vrojtimit më të mirë makinës i janë bërë edhe dy vrima, e vërtetuar kjo nga prokurorja, e cila ka gjetur makinën tip "Benz" në fshatin Poçem të Tepelenës. Pak kohë pas zhdukjes së Albanos, Edison Harizaj ekzekutohet në afërsi të Shkozetit në Durrës, në një atentat tipik mafioz, në të cilin mbeti i plagosur edhe mik i tij, Genci Çaçi. Në dosjen e prokurorisë janë vetëm gëzhojat e sekuestruara në vendngjarje dhe skelletet e dy makinave, një të djegur që autorët braktisën dhe makina e bërë shoshë nga plumbat, me të cilën udhëtonte Harizaj dhe shoku i tij. I papërmendur asnjëherë publikisht, por i

skeduar nga policia si një person me rrezikshmëri të lartë, vetëm pas vrasjes, në media rrodhën informacione në lidhje me aktivitetin kriminal të Edison Harizaj. Informacionet implikonin Harizajn edhe në vrasjen e gjyqtarit Skerdilaj Konomi, ngjarje kjo e ndodhur në shtator të vitit 2013. Makina e gjyqtarit shpërtheu në qendër të Vlorës. Harizaj kishte përfituar edhe nga sistemi i drejtësisë duke kryer pak vite burg, pasi u dënua fillimisht me 24 vite vjet heqje lirie për akuzën e vrasjes të shtetasit Erjon Ahmeti dhe plagosjen e rëndë të dy shokëve të tij, Ferdinand Deda dhe Neritan Rama, krim i ndodhur në 22 korrik 1999. Një tjetër i zhdukur në Vlorë, saktësisht mesditën e 22 nëntorit të vitit 2016 është edhe Leonard Mehmeti, babai i tre fëmijëve. Vëllai i tij rrefeu në emision se ishin shokët e tij, që e lajmëruan për zhdukjen e të vëllait. Ajo që dihet për Leonardin është se mesditën e 22 nëntorit të vitit 2016 është nisur nga Vlorë në drejtim të Tiranës. Mehmeti tregon se i vëllai rrefeonte shpesh Durrësin, për shkak të miqësisë që kishte me Ervin Dalipajn, punonjës policie dhe Xhino Dautajn, i proceduar dhe dënuar në vitin 2012 nga Gjykata e rrethit të Vlorës për vrasje me paramendim. Mehmeti thotë se zhdukja e të vëllait ka lidhje pikërisht me implikimin e tyre në trafikun e drogës. Ish-shefi i Krimin Ekonomik në Ti-

VRASJET

Pak kohë pas zhdukjes së Albanos, Edison Harizaj ekzekutohet në afërsi të Shkozetit në Durrës, në një atentat tipik mafioz, në të cilin mbeti i plagosur edhe mik i tij, Genci Çaçi. Në dosjen e prokurorisë janë vetëm gëzhojat e sekuestruara në vendngjarje dhe skelletet e dy makinave, një e djegur që autorët e braktisën dhe makina e bërë shoshë nga plumbat, me të cilën udhëtonte Harizaj dhe shoku i tij.

trupi të kompozuar në afërsi të ishullit të Sazanit. Familjarët identifikuan viktimën si Ardian Hitaj, babai i tre fëmijëve, banor i lagjes "4 heronjtë", për të cilin ishte bërë kallëzim për zhdukje në muajin mars. Ngjarja është raportuar si mbytje, duke iu referuar ekspertizës mjeko-ligjore, sipas të cilës trupit nuk i janë konstatuar shenja dhuna. Më 26 qershor 2017, Prokuroria e Vlorës ka mbyllur hetimet me argumentin se nuk ka veprë penale. Si peshkatarë të humbur janë raportuar nga Policia e Vlorës edhe zhdukja e Leonard Senkajit dhe shokut të tij Taulant Çerenshitit, edhe pse vetë familja e Senkajit e pranon se ishin të përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike. Ferzilete Senkaj tregon se i biri kishte kryer 4 vjet burg në Leçe, pasi ishte arrestuar në tentative për trafikimin e lëndëve narkotike në brigjet italiane. "Një person që ne nuk e njohëm fare na ka sjell këtu cantën dhe telefonin e tij. Atë e pyetëm se kush je ti, por na tha se nuk dimë asgjë për të, nuk foli", tha nëna. Gjetjen e trupit të djalit të saj apo hetimin e ngjarjes është gjithë sa kërkon familja Senkaj. Ka bindjen se deri më tani organet ligjzbatuese nuk janë përpjekur për zbardhjen e implikimit të djalit të saj. Dyert e mortit nuk ka guxuar t'i hapë as Përpamir Maze, që jeton në një një shtëpi të papërfunduar në lagjen "15 Tetori", në qendër të qytetit të Vlorës. I biri, Ariseldi është zhdukur mëngjesin e 3 korrikut 2017. 32-vjeçari ka dalë nga shtëpia për të mos u kthyer më kurrë. Familja ka mësuar se Ariseldi ka dalë për peshkim së bashku me mikun e tij, Adriano Jahaj, i njohur si biznesmen në qytetin e Vlorës. Rrethanat e zhdukjes së Ariseldit Mazed dhe Adriano Jahaj janë rasti i vetëm për të cilin policia e Vlorës e ka referuar në prokurorinë për dyshime në përfshirjen e trafikut të drogës. Por, me gjithë referimin e ngjarjes nga policia e Vlorës, zyrtarisht Adriano Jahaj nuk ekziston. Me këtë emër biznesmeni njihet vetëm mes miqsh në Vlorë, pasi në dokumente zyrtare dhe pronën e tij, një hotel te lagja e njohur si "Uji i Ftohtë" në Vlorë është i regjistruar me emrin Fatosh Jahaj. Dosja është rikthyer sërish në Prokurorinë e rrethit të Vlorës, ndërsa familjarët e biznesmenit nuk pranojnë të flasin, pasi jetojnë me shpresën se 53-vjeçari është ende gjallë.

PERSONAT E ZHDUKUR NE VLORE NË TRI VITET E FUNDIT

1. ALBANO XHAFERRAJ
2. GAZMEND MERKAJ
3. LEONARD MEHMETI
4. MARJO METUSHI
5. QAMIL LAZE
6. LEONARD ÇENKAJ
7. TAULANT ÇEREMISHTI
8. ARISELD MAZE
9. ADRIANO JAHAJ (FATOSH JAHAJ)

ranë, i akuzuar për rrëmbimin, torturimin dhe vrasjen e Gazmend Çollakut u ekzekutua në prill të vitit 2017, teksa po lëvizte me një makinë "Audi" së bashku me mikun e tij Juxhin Dauti në autostradën Tiranë-Durrës, në afërsi të kryqëzimit të Sukhtit. Ngjarja është ende e pazbardhur për policinë, ndërsa Mehmet Mehmeti thotë se zhdukja e të vëllait ka lidhje pikërisht me implikimin e tyre në trafikun e drogës. "Top Story" vizitoi dhe familjen e Bahri Metushit, i cili jeton në lagjen "28 Nëntori", në Vlorë. Marjo Metushi rezultoi i zhdukur që nga 16 qershori i vitit 2017. Prokuroria ka pezulluar procedimin ndaj tij, e regjistruar për veprën penale, kalim të paligjshëm të kufirit. Bahriu thotë se i biri ishte i përfshirë në trafikimin e lëndëve narkotike. "Me transport me gomone, ka qenë pilot. E ka bërë tërë kohën, nga Shqipëria në Itali. Ikte dhe vinte edhe me kohë të keqe. Nuk vinte me shokë, por vetëm. E keqja e tij ishte se nuk tregonte se nga po vinte", tha babai. Në vitin 2000, Marjo është arrestuar nga policia italiane ku edhe ka vuajtur dënimin me 5 vjet heqje lirie. 70-vjeçari thotë se ishin arsyet ekonomike, ato që e detyruan të birin të rimerrte përsipër dërgimin e lëndëve narkotike përtje

detit. Pazaret për drogën apo dhe pagesa për punën e kryer në transportin e lëndëve narkotike gjatë muajit gusht 2017 është arsyeja që Bahri Metushi beson se është vrarë i biri. 70-vjeçari thotë se Marjo transportonte lëndë narkotike në Itali për llogari të një grupi kriminal në rrethin e Fierit, por policia dhe prokuroria nuk kanë hetuar për zbardhjen e ngjarjes. "Atë natë që është nisur ky, janë nisur edhe dy gomone të tjera. Mario u gjet, por u gjet i qëlluar. I mbytur", u shpreh babai. Qamil Laze është një tjetër i zhdukur; trupi i të cilit u gjet 1 milje larg Bregut, pranë ishullit të Sazanit, mëngjesin e 24 marsit të vitit 2017. Familjarët kishin denoncuar zhdukje e tij më 11 mars, datë në të cilën policia gjeti edhe një gomone të braktisur pranë ishullit me pako me 1.2 tonë lëndë narkotike. Në lagjen "Isa Boletini", ku jeton familja Laze, ende mbahet zëri për peshkatarin që të gjithë e njohin me emrin Numan. Trëndafille Laze, gruaja e peshkatarit tregon se është lajmëruar për kufomën e të shoqit nga peshkatarët, që e gjetën trupin në det. E ndërsa familja Laze i mbylli hesapet me drejtësinë me varrosjen e Manes, më 6 maj 2017, salla operative e Drejtorisë Vendore të Policisë lajmërohet për gjetjen e një

Caritas-i polak, 110 mijë euro dhuratë

Polonia, ndihmë direkte për të prekurit nga përmbytjet e dy viteve të fundit në Shqipëri

Caritas-i polak është një nga strukturat që po gjendet më afër me problematikat shqiptare. Dhe, nuk është habi që kohët e fundit Caritas-i polak (Caritas Poland) ka destinuar 110.000 euro, të mbledhura nga dhurimet speciale të polakeve në ndihmë të të prekurve nga përmbytjet e dy viteve të fundit në Shqipëri. Kjo ndihmë është veç të tjerash, përgjigje e angazhimeve të qeverisë polake gjatë vizitës zyrtare të Kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Varshavë më 6 dhjetor

2017. Ndihma e Caritas-it polak mbërriti te 130 familje shqiptare. Projekti i ndihmës polake ka qenë i ndarë në dy etapa. Etapa e parë u përbush në rajonin e Shkodrës, ku u ndihmuan familje të prekura nga fatkeqësitë natyrore në formën e materialeve të ndërtimit për të riparuar shtëpitë e përmbytura. Ndihma u materializua mes të tjerash në formën e blerjes së materialeve të ndërtimit, mobilie dhe artikujve të përdorimit

bazë. Etapë tjetër e ndihmës ka qenë blerja e pajisjeve elektro-shtëpiake (pjesërisht të prodhuara në Poloni) për familje nga zona e Kamzës, të cilat kanë vuajtur pasojat e përmbytjeve. Për familjet në këtë zonë u dhuruan 70 frigoriferë, 75 lavatrice, 20 soba elektrike dhe me gaz, kaloriferë, hekurat etj. Artikujt me etiketën "Caritas Polska" iu dhuruan familjeve në nevojë. Listën e nevojave e patën përgatitur me kohë priftërinjtë

polakë me mision në Shqipëri, në bashkëpunim me Caritas-in shqiptar. Në ceremoninë e dorëzimit të ndihmës ishin të pranishëm kryetari i Bashkisë Kamëz, Xhelal Mziu; përfaqësues të tjerë të pushtetit vendor; përfaqësues të "Caritas Albania", famullitari i kishës Shën Gjon Pali II në Bathore, Ati Andrezj Michon si dhe ambasadori i Republikës së Polonisë në Tiranë, Karol Bachura. Dorëzimi i ndihmës nga "Caritas Poland"



përkon me momentin e bukur të festës së Pavarësisë së Shqipërisë, 28 Nëntor, por edhe me afrimin e

festave të fundvitit, rast pra i mirë për të festuar dhe qenë me shpirt pranë njerëzve në nevojë.

Eksperti: Sistemi helen i sigurimeve shoqërore nuk kthen pas paratë për shqiptarët

Emigrantët në Greqi, sa vite duhet të punoni që të merrni pension

Kriteret për të përfituar edhe pensionin kombëtar

Voltiza Duro

Emigrantët shqiptarë që kanë punuar me siguri me shtetin helen dhe përbushin kriteret e përcaktuara mund të përfitojnë pension nga Greqia. Sipas ligjit grek për sigurimet shoqërore, në momentin që emigranti është i siguruar dhe ka 6 mijë ensima, që i korrespondojnë 20 viteve punë, ose 4500 ensima, e konvertuar në 15 vite punë do të marrë pensionin kombëtar. Përkatësisht për 20 vite punë atij i takojnë 384 euro në muaj, ndërsa për 15 vite punë do të marrë një pagesë pensioni prej 345 euro në muaj plus pensionin që i korrespondojnë nga kontributet që ka paguar.

KUSHTET

Përderisa një person është në tregun e punës dhe paguan kontribute, ai dhe punëdhënësi ose vetëm ai, po të jetë i vetëpunësuar, mbi bazën e këtyre kushteve, pra 67 vjeç ose 62 vjeç me 40 vite pune me siguracion dhe 20 ose 15 vjet minimumi, do të marrë një pension siç e merr kushto që punon në Greqi dhe paguan sigurimet shoqërore. Në kushtet kur individ ka më pak se 4 mijë ensima, kjo periudhë pune me kontribute nuk përlogaritet në pensionin kombëtar, por nuk do të thotë që nuk mund të përfitojë pension. Në këto raste, emigranti do të marrë Kompensimin e të Moshuarit të Pasiguruar, pasi të mbushë 67 vjeç dhe vlera e këtij kompensimi do të jetë 350 euro.

Përderisa nuk përbush kushtin për 15 ose 20 vitet, legjislacioni ofron mundësinë që të marrë këtë kompensim të të Moshuarit të Pasiguruar që ua ofron sistemit atyre që janë mbi 67 vjeç.

MOSKTHIMI I PARAVE

Sipas ekspertëve grekë, sistemi grek i sigurimeve shoqërore nuk i kthen pas paratë që individit ka paguar



67

VJEÇ, MOSHA
Në këto raste, emigranti do të marrë Kompensimin e të Moshuarit të Pasiguruar, pasi të mbushë 67 vjeç dhe vlera e këtij kompensimi do të jetë 350 euro.

384

EURO, 20 VITE PUNË
Për 20 vite punë atij i takojnë 384 euro në muaj, ndërsa për 15 vite punë do të marrë një pagesë pensioni prej 345 euro në muaj plus pensionin që i korrespondojnë nga kontributet që ka paguar.

për sigurimet shoqërore vullnetarisht. "Sistemi grek i sigurimeve shoqërore, besoj se është i vetmi sistem në Europë që nuk i kthen mbrapa paratë, nëse nuk përbush limitet minimale të kushteve. Domethënë, nëse je në një vend tjetër, në Suedi, në Norvegji, në Gjermani apo në

Francë dhe ligji thotë që duhet të kesh 15 vjet dhe ti ke 10 vjet, ato para që ke paguar për 10 vjet, sistemi t'i kthen ty. Këtu në Greqi kjo nuk bëhet, të paktën deri më sot. Dhe ndoshta ligjëvënasi vendosë ta kompensojë këtë mungesë me dhënien e këtij kompensimi për të Moshuarin

e Pasiguruar", - thekson Savvas Robolis, pedagog i ekonomisë në Universitetin Panteion, është një nga ekspertët më të mirë të sigurimeve shoqërore në Greqi. Ndërkohë të gjithë personat që kanë punuar me kontribute në Greqi, por janë rikthyer në Shqipëri, mund të pretendojnë pension e do të marrë shumën që i korrespondojnë për kontributet që ka paguar ai dhe punëdhënësi i tij gjatë kohës që punonte në shtetin helen. Nëse nuk merr pension nga Shqipëria, atëherë nga vendi prites, pra Greqia, do të marrë edhe pensionin që i takon në bazë të kontributeve që ka paguar, por edhe pensionin kombëtar që finançohet nga buxheti i vendit prites. Pra, personi që jeton në Shqipëri dhe merr një pension nga Shqipëria, nga Greqia do të marrë pen-

sionin për vitet me siguracion që i korrespondojnë dhe jo pensionin kombëtar. Në rast se jeton në Greqi dhe nuk merr pension nga Shqipëria, do të marrë edhe pensionin kombëtar. "Nëse merr pension nga shteti, në vendin tjetër ku je emigrant, do të marrësh vetëm pensionin që të korrespondojnë në bazë të kontributit për siguracion dhe pagës që ke deklaruar ti dhe punëdhënësi yt. Domethënë, nuk mund të marrësh dy pensione kombëtare, nga dy buxhete shtetërore", - thotë Robolis.

PUNA NË TË ZEZË

Emigrantët shqiptarë duhet të kërkojnë punën e deklaruar dhe me siguracion dhe jo punën e pa deklaruar dhe pa siguracion, siç ndodh jo rrallë pas vitit 2010 dhe krizës që pasoi. Elementi i dytë që duhet të kërkojnë në mënyrë kolektive, është që të ushtrojnë trysni ndaj të dy vendeve që të avancojnë në fillimin e bisedimeve për nënshkrimin e një marrëveshjeje ndërshtetërore për sigurimet shoqërore. "Kemi tani edhe përfaqësuesit e kreditorëve, diskutimet që po bëhen për reduktimin e mëtejshëm të pensioneve pas 1 janarit 2019. Në këtë studim ne tregojmë se nuk është e nevojshme që të reduktohen pensionet nga 1 janari 2019. Nuk krijohet problem as për jetëgjatësinë e sistemit deri në 2070, domethënë nuk i krijohet deficitë sistemit. Me ligjet që u votuan jo vetëm në Greqi, por edhe në vende të

6

MIJË ENSIMA
Sipas ligjit grek për sigurimet shoqërore, në momentin që emigranti është i siguruar dhe ka 6 mijë ensima, që i korrespondojnë 20 viteve punë, ose 4500 ensima, e konvertuar në 15 vite punë, do të marrë pensionin kombëtar.

tjetër, në shpenzimet për pensionet kanë vënë një tavan nga BE që mos të kalojë 16% të prodhimit të përgjithshëm të brendshëm. Këto shpenzime në Greqi në 2070 do të jenë 10,6%, që në raport me 2016-ën ka një diferencë shumë të madhe. Mesatarja e BE-së duket se do të jetë (në 2070) 11,4%. Do të thotë që vendimi dhe strategjia politike është që shpenzimet për pensionet t'i mbajnë të ulëta, por nga ana tjetër ulen edhe pensionet. Për Greqinë këto parë që deri në 2050, 2060, pensioni mesatar, kryesor dhe suplementar së bashku, do të jetë 900 euro. Në vendet e tjerë të Europës do të jetë analog dhe në varësi të nivelit të jetesës, inflacionit etj.", - thekson Robolis.



Katër fëmijët e familjes Çoniku, në mëshirë të fatit: Si ia dalim me 150 mijë lekë

Voltiza Duro

Edhe këtë vit, ata do t'i kalojnë netët e gjata të dimrit plot ankth, mbështjellë nën batanijet e ftohta. Të rrethuar nga muret plot lagështirë, katër fëmijët e familjes Çoniku në fshatin Çeravë të Pogradecit duhet të jetojnë edhe me tmerrin e kabinës elektrike, që kanë ngjitur me shtëpinë. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", vajza më e madhe e familjes, 16-vjeçarja Ina Çoniku tregon me lot ndër sy se i ati i ka vdekur në muajin shkurt të këtij viti, pas një sëmundjeje tumorale që nuk mundi ta luftonte. Katër të miturit ndihen të vetëm në këtë botë, pasi edhe nëna e tyre nuk mund të kujdeset siç duhet për ta pasi është shurdhemece dhe ka një sërë problemesh të tjera shëndetësore. Më tej, Ina rrëfen momentet e tmerrit kur kabina elektrike ka marrë flakë, duke rrezikuar jetën e saj dhe të familjes. Fëmijët ndjekin shkollën rregullisht, pasi dëshirojnë të arsimohen e të realizojnë ëndrrat e tyre, por të ardhurat totale për këtë familje janë vetëm 150 mijë lekë të vjetra në muaj e iu dalin vetëm për të mbajtur frymën gjallë. Në rolin e kryefamiljares së shtëpisë, 16-vjeçarja Ina, dëshpërimisht i bën thirrje shtetit shqiptar si dhe të gjithë atyre që kanë mundësi që të kontribuojnë sadopak për motrat e vëllain e saj të vogël.

Sa veta jetoni në këtë shtëpi?

Në këtë shtëpi unë jetoj së bashku me nënën, dy motrat e mia dhe vëllain. Unë jam më e madhja, 16 vjeçe, është motra tjetër 15 vjeçe, motra e vogël 12 vjeçe dhe më i vogli është vëllai 10-vjeçar.

Po babai juaj ku ndodhet?

Babai im ka vdekur para 10 muajsh nga një tumor në trurin e vogël. Ai u largua njëherë e përgjithmonë nga kjo botë, pasi nuk mundi që ta luftonte sëmundjen e ta mposhte atë. Tani ne jemi vetëm, 4 fëmijë dhe me nënën e sëmurë. Nuk kemi asnjë mbështetje dhe unë që jam më e madhja ndjej vështirësitë që kalojmë edhe më

Të bashkëjetosh me tmerrin, 16-vjeçarja rrëfen jetën në kabinën elektrike

"Kemi frikë për jetën, ka pasur raste kur kemi luftuar me flakët"



Familja Çoniku dhe shtëpia e saj



tepër se të tjerët. Para se të ndërtonte jetë, babi ishte i sëmurë dhe merrte KEMP për prapambetje mendore. **Si paraqitet gjendja shëndetësore e nënës suaj?** Mami është 49 vjeçe, por gjendja shëndetësore e saj nuk është dhe aq e mirë, sepse ajo nuk flet dhe nuk shikon mirë, gjithashtu vuan dhe nga tensioni i lartë. Ne arrijmë të shikojmë trishtimin nëpërmjet syve të saj, besoj se ndihen shumë keq për situatën ku ndodhemi, por është e pafuqishme, nuk mund të bëjë asgjë për të ndryshuar gjendjen ku ne ndodhemi.

Sa janë të ardhurat për familjen tuaj dhe a mjaftojnë për të kaluar muajin?

Gjithësej të ardhurat në familjen time janë 150 mijë lekë të vjetra në muaj dhe nuk janë të mjaftueshme, pasi në këtë shtëpi jetojmë 5 veta. Ne shkojmë në shkollë, na duhen fletore, çanta, rroba për të mos folur edhe për ushqimin e për ilaçet që i duhen mamit. Nuk mund të jetojmë 5 persona me 150 mijë lekë të vjetra, këto dalin vetëm për bukë e nevojat e tjera nuk i mbulojmë dot.

"Gjithësej të ardhurat në familjen time janë 150 mijë lekë të vjetra në muaj dhe nuk janë të mjaftueshme, pasi në këtë shtëpi jetojmë 5 veta. Ne shkojmë në shkollë, na duhen fletore, çanta, rroba për të mos folur edhe për ushqimin e për ilaçet që i duhen mamit. Nuk mund të jetojmë 5 persona me 150 mijë lekë të vjetra, këto dalin vetëm për bukë e nevojat e tjera nuk i mbulojmë dot", - thekson 16-vjeçarja.

A punon ndonjë prej jush? Jo! Mami është e sëmurë e normalisht që nuk punon dot, por edhe ne jemi në shkollë e

duhet të ndjekim mësimin, kështu që përpiqemi të mbijetojmë me ato pak lekë që marrim nga pensioni i mamit si invalide. Kemi si synim kryesor që të shkollohemi e të bëhemi dikushi në jetë, prandaj nuk dua që asnjë prej nesh të punojë e të braktisë shkollën.

Si janë kushtet në shtëpinë tuaj?

Banesa ku ne jetojmë përbëhet nga 2 dhoma të vogla dhe një korridor, gjithashtu dhe një banjë e vogël. Shumë kohë më parë, madje para se të martohej babi dhe mami, babi ka banuar këtu dhe kumuna ia ka dhënë këtë ndërtesë për shkak se nuk kishte vend tjetër ku të shkonte, se nuk kishte mjaftueshëm të ardhura për të blerë një shtëpi të saktë. Dua të them gjithashtu se shtëpinë tonë me kabinën elektrike i ndan vetëm një mur. Pra, jetojmë ngjitur me të, e kjo na rrezikon edhe jetën.

A ndiheni të frikësuar që jetoni ngjitur një kabine elektrike?

Normale që kemi frikë, çdokush do të kishte frikë që të jetonte në një banesë si kjo duke e ditur që nga çasti në

"Babai im ka vdekur para 10 muajsh nga një tumor në trurin e vogël. Ai u largua njëherë e përgjithmonë nga kjo botë, pasi nuk mundi që ta luftonte sëmundjen e ta mposhte atë. Tani ne jemi vetëm, 4 fëmijë dhe me nënën e sëmurë. Nuk kemi asnjë mbështetje", - thotë Ina.

A ka pasur raste kur kabina ka marrë flakë dhe jeni ndier të rrezikuar?

Në stinën e dimrit, me kushtet e këqija të kohës e reshjet e shiut, situata bëhet edhe më e rrezikshme për ne. Madje, ka pasur disa raste që kabina ka marrë flakë, e kjo

MOMENTET E TMERRIT

"Sidomos kur është kohë e keqe mund të bjerë zjarr dhe të digjemi. Madje, ka pasur disa raste që kabina është përfshirë nga flakët, por fatmirësisht e kemi shuar në kohë zjarrin pa arritur që të dëmtojë banesën. Jemi tmerruar, nuk dija si të reagoja, më duhej t'i shpëtoja të gjithë", - rrëfen Ina.

pasi kemi afër edhe 2 shtylla korrenti dhe telat kanë bërë masë. Kabina është përfshirë nga flakët, por fatmirësisht e kemi shuar në kohë zjarrin pa arritur që të dëmtojë banesën. Jemi tmerruar, nuk dija si të reagoja më duhet t'i shpëtoja të gjithë. Kam marrë vëllain, motrat e mamit dhe kam dalë jashtë në mes të të ftohtit. Kanë qenë momente shumë të frikshme për mua, nuk do të doja t'i përjetoja kurrë më!

Cilat janë kërkesat tuaja, çfarë do të dëshiroje të ndryshonte në jetën tënde?

Së pari do të donim të largoheshim nga kjo shtëpi e shteti të na ofroje një banesë tjetër që të mos na rrezikojë jetën. Jetojmë gjithë frikë, jemi të vegjël e nuk kemi asnjë mbështetje në këtë botë. Kushdo qoftë të vërë dorën në zemër e të na ndihmojë të dalim nga kjo situatë. Duam dhe ne të jemi si gjithë bashkëmoshatarët tonë, të shkojmë në shkollë, të ushqehemi normalisht, e të vishemi si gjithë shokët tanë. Jemi 4 fëmijë të vetëm me nënën që as dëgjon e as flet, kështu që shteti ose çdokush që dëshiron të kontribuojë sadopak për familjen tonë.

Prerja masive e pemëve në parkun më të madh kombëtar të Shqipërisë po shkatërron pyllin natyror të mbrojtur nga UNESCO, zbulon një investigim i BIRN

Bandat e druvarëve: Plaçkitja e pyjeve të lashta të Shqipërisë

Arllis Alikaj *

Shoferi futi kamionin pro dhim sovjetik me marsh të parë kur hyri në rrugën malore. Duke ecur mbi një shkëmb të madh, kamioni u anua rrezikshëm pranë humerës. Poshtë, një det me re shtrihet në horizont.

"Dashtë Allahu, o do t'ia dalim, ose do të vdesim", tha shoferi.

Fatalizmi i tij nuk solli shumë qetësi.

Kamioni u fik, u tund dhe më pas u rikthye në punë. Duke shkelur butë gazin, ai ia doli të kapërcëjë shkëmbin për të hyrë në një shteg balte.

Kjo ishte vetëm një nga ditët e zakonshme të tregut të zi të drurit në parkun kombëtar Shebenik-Jabllanicë në Shqipërinë Lindore.

Pavarësisht ndalimit strikt të prerjes së pyjeve dhe regjistrimit të një pjese të Shebenik-Jabllanicës si vend i trashëgimisë botërore të mbrojtur nga UNESCO, rrjetet kriminale po shkatërrojnë pyjet natyrore për të furnizuar me dru zjarrit tregun e vendit, zbuloi një investigim nga rrjeti ballkanik për gazetari investigativ.

Më shumë se 2 mijë metra mbi nivelin e detit, pyjet e virgjëra të ahut në parkun më të madh kombëtar të Shqipërisë rriten të larta dhe të gjera, duke i bërë ato plaçkë të rëndësishme në një vend që ka humbur shumicën e pyjeve të veta përgjatë pesëdhjetë viteve të fundit.

Nga rryshfeti të lejet e falsifikuara apo të flotat e kamionëve të pajisur me mjete gjurmimi satelitore, investigimi i BIRN zbulon përmasat në të cilat druvarët ilegale shfrytëzojnë zonat e mbrojtura.

Ai thekson gjithashtu kulturën e pandëshkueshmërisë në një vend kandidat për anëtarësim në BE, që po vuan të vendosë sundim ligji në fushën e mbrojtjes së natyrës.

Në lojë është shëndeti i një ekosistemi që shërben si mushkëri e Shqipërisë. Pyjet e larta ndihmojnë për të stabilizuar klimën e zonës, duke rregulluar reshjet dhe duke ndihmuar qarkullimin e ajrit, thonë mjedisorët.

I gjendur në kufi me Maqedoninë, parku është gjithashtu një nga zonat e fundit të mëdha të egra në Europën Juglindore, ku tufa ujsh të hirtë konkurrojnë me sharrat elektrike.

Bashkë me pyjet e virgjëra të ahut, sharra rrezikon bimë dhe kafshë të rralla, përfshirë zambakun shqiptar, ariun e murrmë, shqiponjat e arta dhe rrëqebullin në rrezik zhdukje të njohur ndryshe si "tigr i Ballkanit".

"Parku Shebenik-Jabllanicë është, një nga parqet më të bukura në Ballkan, por në anën juglindore të tij është dëmtuar shumë", thotë Ahmet Mehmeti, udhëheqës i një grupi mjedisorësh të quajtur



Klubi Ekologjik i Elbasanit dhe një konsulent në prokurorinë e shtetit për krimet kundër mjedisit.

"Ata përgjegjës për tregtinë e paligjshme të drurit të zjarrit po thejnë ligjin dhe po përdorin parkun për të bërë miliona për vete".

Masakra mjedisore
Më 2016-ën, Shqipëria vendosi një moratorium 10-vjeçar në shfrytëzimin e të gjitha pyjeve të veta dhe ndaloi eksportin e drurit. Ndalmi erdhi pas dekadash shfrytëzimi të egër, që zhveshi shtapat dikur të gjelbra të vendit dhe shkaktoi erozion.

Autoritetet mund të vijojnë të lëshojnë leje për prerje pemësh në zona specifike për të plotësuar nevojat për dru zjarrit për popullsinë vendase, por parqet kombëtare janë rreptësisht të ndaluara.

Sipas Kodit Penal shqiptar, shkelësit mund të dënohen me deri tetë vjet burg për dëmtimin e zonave të mbrojtura.

Të dhënat më të fundit nga "Global Forest Watch", një shërbim me bazë në SHBA që monitoron pyjet në të gjithë botën, tregojnë se pyjet mbulonin 17% të Shqipërisë më 2010.

Mes viteve 2001 dhe 2017, humbja e mbulesës me pyje në vend ka sjellë çlirimin e pothuajse tre megatonëve dioksid karboni, thotë "Global Forest Watch".

Një pjesë e pyjeve të mbetura është në Parkun Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, i cili përbën 70% të biodiversitetit të Shqipërisë, sipas Klubit Ekologjik Shqiptar, një grup mjedisorësh.

Parku me sipërfaqe 340 kilometra është pjesë e Brezit të Gjelbër të Europës, një rrjet zonash ekologjike me rëndësi për Komunitetin Europian. Pyjet e lashta të ahut përreth fshatit të thellë të Rajcës në cepin jug-lindor të parkut morën mbrojtje nga UNESCO më 2017-ën.

Pëllumb Gjini, ish-kryekomunar në fshatin Steblevë në veri të Shebenik-Jabllanicës, ndihmoi në organizimin e pleqësisë për krijimin e parkut kombëtar më 2008, pasi druvarët shkaktuan dëme "të stërmëdha" për shumë vite me radhë.

"Por ironikisht situata nuk u përmirësua dhe masakra mjedisore vijon", i tha ai BIRN. "Biznesi prej miliona dollarësh e bën të lehtë injorimin e asaj që po ndodh duke e lënë zonën pa një plan menaxhimi".

"Rreth 80 për qind e banorëve të zonës mbështeten te drutë e zjarrit për ngrohen gjatë muajve të gjatë të dimrit", shtoi Gjini.

"Biznesi prej miliona dollarësh e bën të lehtë injorimin e asaj që po ndodh".

INVESTIGIMI I BIRN

Nga 26 rastet e prerjes së paligjshme që u janë referuar prokurorëve përgjatë dy viteve të fundit, 23 prej tyre përfunduan me ngritje akuzash, por vetëm një person u dënua - një burrë nga Rajca, i cili mori një gjobë prej 650 eurosh për prerje pemësh pa leje.

Pëllumb Gjini, ish-kryekomunar në Steblevë

Ministria e Mjedisit nuk iu përgjigj kërkesës për intervistë apo pyetjeve me shkrim mbi prerjen e paligjshme të pyjeve.

Por, Enver Shkurti, drejtor i Inspektoratit të Mjedisit për Qarkun Elbasan, institucioni përgjegjës për zbatimin e ligjit në park, mohoi se këtu kishte një problem gjatë një interviste në një kafene në Librazhd, qyteti më i afërt me parkun.

"Nuk është e vërtetë se ka prerje të paligjshme të pyjeve në park", tha Shkurti, i cili ka qenë zëv-

endëskryetar Bashkie në Librazhd nga viti 2015 deri në fillim të vitit 2018. "Institucioni ynë nuk ka informacion mbi asnjë prerje të paligjshme në park, megjithëse mund të ketë raste të izoluar".

Investigimi i BIRN zbuloi një pamje tjetër.

Në një udhëtim njëditor të fshehtë me prerësit në zonën e mbrojtur nga UNESCO pranë Rajcës, BIRN pa parcela pyjesh të virgjëra ahu që po pastroheshin. Në shtatet e larta mbi retë gjendeshin pirgje me drurë të saporrë në pritje për t'u ngarkuar. Zhurma e sharrave dëgjohej kudo.

Ajo që pa BIRN nga bota e tregut të zi të drurëve të zjarrit filloi një mëngjes vere në një kafene pranë rrugës në fshatin Hotolisht, pak kilometra jashtë anës jug-perëndimore të Shebenik-Jabllanicës.


Pesë shoferë që punonin për "bosët" e druvarëve po pinin duhan dhe kafe. Thexsi i tyre tregon se se vinin nga pjesë të ndryshme të Shqipërisë. Targat e kamionëve të parkuar aty pranë tregonin për mjete të regjistruara në rrethe të largëta: Durrës, Fier, Korçë dhe Berat.

Secili shofer punonte për një "kompani" të ndryshme. Detyra e tyre ishte që të lidheshin me skuadrat e druvarëve në malet e Shebenik-Jabllanicës dhe të ngarkonin lëndën drusore.

Shoferët filluan të debatonin se kush do të merrte ngarkesën më të mirë nga lartësitë më të mëdha në park. Sa më e mirë të ishte lënda drusore, aq më i madh ishte fitimi i tyre.

Në tavolinë ata kishin të dhëna mbi lëvizjet e oficerëve të policisë vendore - të vlefshme për planifikimin e rrugës dhe shmangien e patrullave.

Pak më vonë, një njeri tjetër mbërriti në kafene: plaku i njëri



"Kryeplaku përcakton gjithashtu vendet ku priten pemët", tha ai. Shoferët e dinë se çfarë shtigjesh të ndjekin në park sipas shenjave të vendosura me bojë në shkëmbin apo degë pemësh në degëzimet e rrugëve të pashtuara. Secili kompani ka ngjyrën e vet të përcaktuar. Sa më i madh të jetë rryshfeti, aq më e pasur është parcela për t'u prerë.

Armë dhe sharra
Ndërsa ai përparoi në park, shoferi mori telefonata nga bosët, përmes tre telefonave të ndryshëm celular, secili me një bateri të jashtme. Ai tha se kamioni kishte pajisje të gjurmimit satelitor për të ndihmuar punëdhënësit që të ndiqnin vendndodhjen e tij.

Në një degëzim rruge, kamionët u ndanë.

Duke dalluar ngjyrën e kompanisë së tij në një trung, shoferi mori një shteg të pjerrët, që gradualisht u bë edhe me baltë dhe me gurë. Për 45 minuta që pasuën, kamioni çau ngadalë përpara duke u tërhequr herë pas here pas. Në një pikë, ai ndali kamionin, zbriti, vendosi shkopiinj e gurë nën rrota në mënyrë që të mund të çante nëpër baltë.

Herë pas here burra me syze dielli shfaqeshin mes pemëve për t'u siguruar se kamioni do të ndiqte shtegun e duhur, i cili duhej se ishte hapur nga një buldozer që gjendej i parkuar aty pranë.

Një i ri trupmadh përshëndeti shoferin dhe i dha atij dy apo tri dokumente që shoferi tha se ishin lejet për të prerë dru në Dardhë, rreth 30 kilometra në jug të parkut.

"Këto letra do të më shpëtojnë", tha shoferi.

Kur kamioni në fund mbërriti në destinacion në kresh tën e malit pranë fshatit të vogël Rrajca-Skenderbej, më shumë se 2 mijë metra mbi nivelin e detit, dhjetë banorë vendës filluan të ngarkonin trunqe ahu gjigant në kamion. Burra të tjerë me sharrë në duar ishin të zënë duke prerë pemët. Stivat e druve gjendeshin gjithkund.

Disa njerëz me armë në brez mbikëqyrnin punën. Njëri rrotulloonte pistoletën në dorë.

"Është për kafshët", tha ai. Një nga punëtorët që po ngarkonte trunqet në kamion →



← ishte një djalë rreth të njëzetave nga një fshat pranë parkut. Larg veshëve të njerëzve me armë, ai tha se e vetmja mënyrë për të mbajtur familjen ishte puna e rëndë në prerjen dhe ngarkimin e pemëve, në disa raste duke punuar natën.

"Mua nuk më pëlqen të pres pyjet - tha ai. - Më vjen turp për çfarë po bëjmë, por çfarë mund të bëj tjetër?"

Si të gjithë njerëzit e përfshirë në prerjet ilegale që folën për BIRN, ai refuzoi të identifikohet.

Në një udhëtim të vështirë duke zbritur nga mali, ndërsa trunget përplaseshin në anët e kamionit të ngarkuar rëndë, shoferi bëri telefonata të bosët për t'u informuar më saktë mbi patrullat e policisë atë ditë - që të sigurohej se nuk do

te bosët dhe punëtorët e tyre. Pjesa tjetër mbulon ryshfetet për zyrtarët e qeverisë.

'Lotët' e pemëve
Mjedisorët thonë se trunget nga parku përfundojnë në tregjet e druve të zjarrit në të gjithë vendin, ku kanë çmim më të lartë për shkak të trashësisë, për shkak se janë të thatë dhe për shkak se vlerësohet se digjen më gjatë në sobë.

Përgjatë pak orëve, BIRN pa kamionë të rëndë që ecnin në një copë rrugë mes qyteteve të Librazhdit dhe Prrenjastit në qarkun Elbasan, të gjitha të mbingarkuara me trunget gati për t'u nxjerrë në treg.

Tregtarët e druve të zjarrit në qytetet juglindore të Pogradecit dhe Korçës dhe në zonën përreth Librazhdit refuzuan të thonë se cili ishte burimi i druve të tyre, por



të kishte ndalesa të padëshiruara. Kërkesat e BIRN për komente nga policia e zonës mbetën pa përgjigje, ndërsa Policia e Shtetit në Elbasan nuk iu përgjigj një kërkesë për të drejtë informimi mbi zbatimin e ligjeve kundër prerjes së pyjeve.

Shoferi tha se ai gjithmonë përpiqej të ngarkonte më shumë dru nga sa lejonte leja e tij false për shkak se çdo rrugë paguhej pak. Nëse dokumenti specifikonte pesë metra kub, ai merrte 15.

"Njerëzit e thjeshtë si unë janë poshtë fare", tha ai, duke shpjeguar se bosët ishin biznesmenë me lidhje me "njerëz të fuqishëm", që lejojnë prerjen e pyjeve.

Ai tha se gjysma e parave të bëra nga shitja e druve të zjarrit shkon

menaxheri i një tregu në Elbasan që kërkoi të mbetej anonim, tha se druri më i mirë vinte nga Shebenik-Jabllanica.

Ai tha se furnizuesit përdornin dokumente false për të treguar se druri ishte prerë në Dardhë, një zonë jashtë parkut, ku autoritetet mund të lëshojnë leje për plotësimin e nevojave të zonës për dru zjarri. "Gjatë verës, druri që me të vërtetë vjen nga Dardha shitet për rreth 24 euro (3 mijë lekë) për metër kub ndërsa druri më i mirë nga Shebenik-Jabllanica shitet për 32-35 euro (4,000-4,500 lekë) - tha ai. - Në dimër, druri nga parku shitet për 55 euro (7,000 lekë)".

Pyetur mbi aludimet se druri nga parku shitet sikur vjen nga zona të tjera kur prerja lejohet, Sh-

ROLI I SHTETIT

Ryshfet e korrupsion/ Kryebashkiakja Rira: Shteti s'ka ndërhyrë për prerjet ilegale

Delegacioni i BE-së në Shqipëri, i cili financon një projekt për të ndihmuar në menaxhimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pyjeve të mbrojtura, përmendi qeverisjen e dobët dhe korrupsionin si pengesa në mbrojtjen e pyjeve. "Zonat e mbrojtura janë të prekura nga shpyllëzimi ilegal, fragmentimi i habitatëve dhe degradimi i ekosistemeve për shkak të kapaciteteve të dobëta administrative, mungesës së aftësive teknike, financimit të paktë dhe korrupsionit në administratë", i tha delegacioni BIRN në një deklaratë me shkrim.

Armando Braho, jurist mjedisor në Universitetin Ndërkombëtar të Strugës, pak përtej kufirit me Maqedoninë, tha se problemi ishte "më shumë politik se sa ligjor".

"Ka interesa politike të lidhura me fitimet, gjë që mundëson këtë aktivitet", tha ai.

Ndërsa shumica e Shebenik-Jabllanicës administrohet nga autoritetet në qytetin e Librazhdit, pjesa jugore e parkut - përfshirë zonat e mbrojtura nga UNESCO përreth Rrajçës - gjendet në bashkinë e Prrenjastit.

"Mendimi ynë është që shteti nuk ka ndërhyrë mjaftueshëm për të bllokuar prerjet ilegale", tha kryebashkiakja e Prrenjastit, Miranda Rira, në një intervistë për BIRN. "Moratoriumi i vitit 2016 nuk është zbatuar dhe popullsia nuk ka alternativa për ngrohje në dimër, gjë që e bën shumë të vështirë ndalimin e prerjeve ilegale".

Ajo tha se bashkia bleu 3,260 metra kub dru zjarri nga burime të tjera për banorët dimrin e kaluar, por me një popullsi prej 25 mijë vetash sipas censurit 2011, furniz-



imi shtesë nuk mjaftoi. "Nëse shteti nuk merr seriozisht nevojën për një alternativë për t'i mbajtur njerëzit ngrohtë, në të ardhmen e afërt pylli unë do të humbasë statusin UNESCO", tha Rira.

Rojet e parkut që punojnë për Administratën e Zonave të Mbrojtura në Librazhd, (APA Librazhd), janë përgjegjës për patrullimin e parkut. Bajram Kullolli, i cili së fundmi u bë i dyti në komandën e APA Librazhd, pas 25 vjetësh pune si roje pylli, tha personeli prej 15 personazh ishte i mbingarkuar dhe pa burimet e nevojshme.

"Shteti duhet... të rrisë pagat, të japë tollona naftë (për automjetet e patrullimit) dhe të rrisë burimet njerëzore", i tha ai BIRN.

Delegacioni i BE-së në Shqipëri lavdëroi APA Librazhd për për-

prerjet e saj për të kontrolluar prerjet e paligjshme, por tha se problemi vijonte për shkak të "kapaciteteve të kufizuara" të administratës dhe "mungesës së angazhimit serioz nga Inspektorati i Mjedisit".

Kullolli tha se zyra e tij kishte dërguar një fundmi katër raste në polici dhe prokurori, por asnjëra prej tyre nuk kishte rezultuar në dënime. Krahas vonesave burokratike, investigimet u penguan nga vështirësia për të provuar se nga vinte druri i prerë, pasi ai ishte thatë - shtoi ai.

Kërkesat për Prokurorinë e Elbasanit për të dhëna të kohëve të fundit për dënime mbetën pa përgjigje si pasojë e ndryshimeve në prokurorinë rajonale të shkaktuara nga reforma në drejtësi, e

kurti nga Inspektorati i Mjedisit në Elbasan tha: "Kjo nuk është e vërtetë. Këto janë probleme të së shkuarës".

Por ai tha se ka pak konfuzion mbi ligjshmërinë e prerjeve jashtë parkut, për shkak të koncesioneve të dhëna para moratoriumit të vitit 2016.

"Disa koncesione u dhanë në vitin 2003 dhe vijojnë deri më 2022 - tha ai. - Kjo na jep ne imazh të keq. Por këto lloj koncesionesh nuk janë përgjegjësia jonë".

Mehmeti, kreu i Klubit Ekologjik të Elbasanit, tha: "Koncesionet kanë abuzuar duke prerë më shumë pemë nga sa janë lejuar, duke prerë në zona pa leje dhe duke ndryshuar letrat për të fshehur origjinin".

Kastriot Gurra, kryebashkiak i Librazhdit, u pyet së fundmi mbi hapësirat në interpretimin e moratoriumit në një intervistë televizive (në shqip).

"Ne nuk kemi aftësinë për të pe-

zulluar apo anuluar kontratat, për shkak se ato u nënshkruan nga Ministria e Mjedisit në vitin 2012", tha ai.

Braho nga Universiteti Ndërkombëtar i Strugës e hodhi poshtë idenë se koncesionet e vjetra mund të shkaktojnë konfuzion ligjor ose të pengojnë zbatimin e ligjit. "Edhe nëse ka një kontratë (para moratoriumit), qeveria mund të gjejë zgjidhje", i tha ai BIRN.

Fermerët vendës përreth fshatrave të Steblevës dhe Dragostun-jës - në anë të ndryshme të parkut - thonë se shpyllëzimi po shkatërron tokat e tyre duke shkaktuar erozion. Fshatarët që mbajnë lopë, dele apo dhi në malet shkëmbore thonë se po humbasin kullotat.

Ndërkohë, njerëzit përreth Rrajçës ankohen se po humbet pylli i virgjër i ahut për të cilin thonë se kanë lidhje shpirtërore.

"Këto pemë u rritën bashkë me mua", tha një tregtar 35-vjeçar, që kërkoi të mbetet anonim nga frika

e hakmarrjes nga prësit e pyjeve. "Unë gdhënda emrin tim në një nga këto pemë dhe shkoja për piknik atje me familjen. Shtoi, kur u ktheva pas, pema nuk ishte më. Ata e kishin prerë. Ishte sikur të më kishin prerë mua".

Në një lëndinë pranë fshatit Rrajca-Skënderbej, ku druvarët ishin të zënë duke prerë pemë, një grua në të shtatëdhjetat po ecte me një gomar për të sjellë drekën për djalin e saj, një prej druvarëve. "A e sheh këtë pikën që rrjedh nga trungu - tha ajo duke bërë me shenjë nga një ah i madh. - Ne e quajmë atë loti i pemës, për shkak se pemët qajnë kur priten".

* Arlis Alikaj është gazetar i lirë në Shqipëri. Redaktimi i krye nga Timothy Large. Ky artikull i realizua si pjesë e Bursës Ballkanike për Gazetari Ekseleente, mbështetur nga Fondacioni ERSTE dhe Fondacionet për Shoqëri të Hapur, në bashkëpunim me Rrjetin Ballkanik për Gazetari Investigative.

PRESIDENTI I REPUBLIKES RREFIMI

"Me ish-kryetarin e PD-së kam marrëdhënie të veçantë, ka kimi tjetër"

Rrëfimi i Ilir Metës: Raportet e mia me Ramën, Berishën e Nanon Presidenti: "Mësuesi" im politik, Dritëroi

Presidenti i Republikës, Ilir Meta ka sqaruar dhe në emisionin "Opinion" të gazetarit Blendi Fevziu, raportet e tij me kryeministrin Rama, kreun e opozitës Basha si edhe me ish-kryeministrin Berisha.

Nga të tre, ra në sy fakti se Meta ka veçuar marrëdhënien e tij me Berishën pasi siç edhe u shpreh: "Marrëdhëniet e mia me z. Berisha janë marrëdhënie të veçanta. Është një kimi tjetër", - ka deklaruar Meta.

Meta u shpreh se me ardhjen e tij në krye të Presidencës dhe axhendat e ndryshme me bashkëshortin kjo nuk u jep mundësinë sipas tij të takohen shpesh. Kjo sipas Metës ishte edhe ndryshimi me i madh që ka ndodhur që kur ai është bërë President: "Tani janë dy axhenda krejtësisht të ndryshme aq sa nuk do ta besoni po kishim disa javë që nuk ishim bashkë për darkë apo për drekë".

PJESA NGA INTERVISTA

Blendi Fevziu: Zoti Meta, mirëmbërë. U bë kohë që nuk jemi parë në një intervistë të tillë. Është një intervistë në fakt që nuk do të ketë lidhje drejtpërdrejt me punën me politikën, edhe pse këto kohë keni qenë në qendër të prozëktorëve politikë për arsye të raporteve me Kryeministrin dhe me dekretimin e Ministrisë Lleshi. Do të doja të fokusohesha te jeta tuaj si President, raportet, çfarë ndryshon dhe do rikthehemi dhe te karriera juaj. Në disa intervista që kemi bërë, kemi folur për pjesën e parë të jetës tuaj, por pothuajse asnjëherë nuk kemi folur për pjesën e angazhimit tuaj politik. Çfarë ka ndryshuar që kur jeni bërë President?

Meta: Për mua i vetmi ndryshim është, që thjesht kam më pak kontakte të karakterit politik apo partiak dhe angazhime më të shumta institucionale dhe shumë detyrime të paevitueshme.

Gazetari: Ku do të doje të ecje me Ramën për shembull, në cilën zonë?

Meta: Për shembull në Qeparo fushë, Qeparo mal, Pilur, në këto zonat e jugut besoj.

Gazetari: Këto zonat e jugut po i zgjedh në raport me pëlqimin e tij me duket më shumë sesa me tuajin?

Meta: Megenëse ai kalon më shumë kohë në Jug, pasi edhe ka pasionet, edhe ka ato lidhjet më të shpeshta, për të lehtësuar atë, pa për mua në çdo kohë, kudo në Veri ose në Jug.

Gazetari: Ndërkohë vazhdoni të keni lidhje me vendlindjen tuaj me Skra-



Presidenti i Shqipërisë,
Ilir Meta

parin?

Meta: Lidhjet e mia me Skraparin janë të përditshme.

Gazetari: E kisha në kuptimin, që a shkoni, e frekuentoni shpesh?

Meta: Shkoj vazhdimisht sidomos, në festat tradicionale, në Malin e Tomorit, festa e bektashinjve.

Gazetari: A ka filluar zona e Skraparit, zoti Meta, si në shumë zona të tjera të zbrazet nga njerëzit për shkak të ikjeve?

Meta: Kjo çështja e ikjeve mendoj që, ka arritur maksimumin e saj dhe tani ne kemi një fenomen të ri që unë e shikoj në Skrapar; por e shikoj edhe në zonat e veriut të Shqipërisë, sic ishte edhe rasti i Currajt, që është ndërjegjësimi i njerëzve për bukurinë e zonave nga vijnë. Mundësitë për të zhvilluar turizmin familjar, dhe unë besoj se janë të gjitha mundësitë dhe ky fenomen po vihet re, që shumë njerëz të cilët dikur në vitet '90 ishin në moshën 30-40 vjeç e tani janë në prag të pensionit, fëmijët e tyre janë rritur, janë bërë të pavarur dhe shikojnë mundësinë për t'u rikthyer, për të riparuar shtëpitë e vjetra, jo vetëm për të jetuar në këto zona për shkak të bukurive, të klimës, nostalgjisë, por njëkohësisht edhe në funksion të turizmit.

Gazetari: Po të kthehesh në darkë në shtëpi të ankohet gruaja gjithë ditën për mënyrën si qeveriset Shqipëria do ndikohesh vetvetiu. Burrat ndikohen nga gratë.

Meta: Së pari, gjëja që ka

ndryshuar më shumë në jetën time si President është për arsye, sepse tani nga një kontakt dhe nga një takim i vazhdueshëm me Monikën për shkak të angazhime të mëparshme në të njëjtën forcë politike apo të dy në Parlament e kështu me radhë, tani janë dy axhenda krejtësisht të ndryshme. Aq sa ju ndoshta edhe nuk do ta besoni që kishim disa javë pa qenë bashkë për drekë apo për darkë, edhe falë ambasadorit të OSBE-së u takuam një ditë që hëngërm darkë së bashku. Kështu që nuk është se jemi në një kontakt të vazhdueshëm përveç rasteve të ditëve të festave.

Gazetari: A ishit ju dakord që zonja Kryemadhi të bëhej kryetare e LSI-së ose a ndikuat ju që të bëhej kryetare e LSI-së?

Meta: Nuk besoj se ka qenë e nevojshme që unë të ndikoj për një gjë të tillë. Përkundrazi ashtu siç kam bindjen që nuk ka qenë një pozitë që edhe Monika vetë e ka kërkuar apo që e ka planifikuar.

Gazetari: Po si, ia bën dhuratë? Sepse ajo kandidoi për kryetare.

Meta: Nuk besoj se në politikë bëhen dhuratat të tilla, aq më tepër dhuratë për të qenë kryetar i një partie në opozitë.

Gazetari: Megjithatë për shumicën e vendimeve a është dakord me ju? Qëllon që ju konteston? Flasin për pjesën private.

Meta: Monika, në qoftë se nuk konteston nuk është më

Monika, kështu që frymën kontestuese edhe rebeluese e ka pjesë të karakterit të vet që nga koha që unë e kam njohur.

Gazetari: Gjatë këtij një viti e pak muaj që ju jeni në krye të Presidencës së Shqipërisë, cili ka qenë momenti më i vështirë që keni pasur?

Meta: Vazhdimisht ka momente nga më të ndryshmet.

Gazetari: Dhe ndërkohë në këtë pozicion që jeni, a keni pasur tensione për shembull në raportet me Kryeministrin, me kreun e Opozitës? Por po i marrim një më një. Me Ramën keni patur tensione?

Meta: Unë përpiqem që çdo raport ta menaxhoj në mënyrën më të përgjegjshme, më bashkëpunuese.

Gazetari: Është pak e çuditshme. Ju jeni njohur me Ramën shumë më përpara sa njeri apo tjetri të hynte në politikë. Kur ju merreshit me ekipin e Dinamos në atë kohë në peshëngritje dhe ai me Dinamon në basketboll apo jo?

Meta: Kanë qenë njohje të papërfillshme.

Gazetari: Ndërkohë ka një komunikim pak më normal përveçse zyrtar mes jush? A fliste ndonjëherë përtej pjesës zyrtare?


Meta: Unë dallohem gjithmonë për komunikime normale. Jam i hapur gjithmonë.

Gazetari: Kjo do të thotë që është Rama që nuk ka komunikim normal?

Meta: Nuk e thashë këtë

MENDIMI PER RAMIZ ALINE

Me ç'na kanë parë sytë pas 1990-s nuk mund të themi se ai nuk bëri përpjekje të rëndësishme për ta ulur avionin sa më butë në pistën e pluralizmit dhe të demokracisë



duhet për të mbrojtur institucionet apo kur duhet për të mbrojtur një çështje të madhe për të cilën përplasja është e paevitueshme. Unë nuk nxi asnjëherë konfliktin dhe nuk jam i apasionuar pas përplasjes, por po të jetë për përplasje këtë e bëj si askush tjetër kur vjen fjala për një çështje të madhe.

Gazetari: Personalisht a keni pasur ndonjëherë raporte me Ramën? A keni biseduar ndonjëherë jo si Kryeministri me ministrin apo me Kryetarin e Bashkisë, jo si dy kryetarë partie, jo si Kryeministri me Presidentin apo me Kryetarin e Kuvendit?

Meta: Kjo është diçka e parëndësishme. Unë kam pasur marrëdhënie shumë të mira, kemi pasur edhe marrëdhënie problematike. Në detyrën që jam, për mua historitë e së kaluarës dhe raportet personale me asnjë nuk vlejnë. Për mua vlen sjellja institucionale, qëllimi i për-bashkët për të cilin duhet bashkëpunuar.

Gazetari: Dhe ndërkohë e keni të vështirë të vendosni raporte personale me të apo refuzoni ta bëni këtë gjë?

Meta: Nuk është ky prioriteti. Prioriteti im në raport me të gjithë në këtë detyrë është bashkëpunimi institucionale.

Gazetari: Iu pyeta jashtë detyrës, më shumë si një raport. Vë re për shembull që pak ditë më parë ka qëndruar për një orë e gjysmë në një takim me ju. Nuk besoj që për një orë e gjysmë është folur për çështjen e Lleshit?

Meta: Çfarëdolloj çështje që të diskutohet nuk ka rëndësi. Kjo nuk i intereson askujt se çfarë pimë ne, kafe apo kakao në kuptimin personal, apo se çfarë shakaje bëjmë.

Gazetari: Po marrëdhëniet me z. Basha si janë?

Meta: Raporte normale, institucionale.

Gazetari: Nuk ka raporte të tjera përtej këtyre?

Meta: Nuk ka ndonjë raport të veçantë.



RAPORTI ME BERISHEN

Kushdo që e njeh Berishën më nga afër dhe punon me të, krijon një mendim tjetër nga mendimi, që mund të krijojë nga media apo duke e perceptuar thjesht si kundërshtar.

Gazetari: Po me z. Berisha?

Meta: Këtu ka një dallim. Kuptohet që marrëdhëniet e mia me z. Berisha janë marrëdhënie të veçanta.

Gazetari: Kur ka lindur kjo "dashuri" e juaja për Berishën, z. Meta? Ju keni qenë kundërshtar politik për një periudhë të gjatë kohe, nga viti 1992 të paktën deri në vitin 2009, kur u bashkuat në një koalicion me të.

Meta: Të gjitha në kompleksin e tyre kanë krijuar një marrëdhënie të veçantë. Është një kimi tjetër.

Gazetari: A keni pasur një mllef ndaj Berishës në vitet 1992-93-94?

Meta: Sa të duash.

Gazetari: Që vinte nga?

Meta: Kuptohet që vitet 1992-1997 kanë qenë vite të vështira dhe padyshim unë kam qenë dhe një nga përfaqësuesit e parë të opozitës, të cilit i është hequr imuniteti, që është kërcënuar me burg e kështu me radhë dhe sigurisht që nuk kanë qenë vite të lehta dhe për demokracinë.

Gazetari: Jeni deputeti i parë i parlamentit pluralist, që i është hequr imuniteti në shtator të vitit 1992 që ka qenë edhe hera e fundit që Nano dhe Berisha kanë komunikuar në telefon në atë moment për ju. Për një 23-vjeçar duket një e ardhme e ndritur, që dy liderët kryesorë të vendit të flasin në telefon për të zgjidhur mandatin tuaj. Më pas kur e keni njohur mirë keni ndryshuar mendim? Kishte një gjë që ndryshoi në perceptimin tuaj?

Meta: Patjetër. Kushdo që e njeh Berishën më nga afër dhe punon me të, krijon një mendim tjetër nga mendimi,

që mund të krijojë nga media apo duke e perceptuar thjesht si kundërshtar.

Gazetari: Dhe gjatë kohës që keni bashkëpunuar si Kryetar i LSI-së me të si Kryeministër, a ka qenë korrekte marrëdhënia juaj zyrtare?

Meta: Shumë korrekte.

Gazetari: Vazhdoni të keni komunikim tani me të?

Meta: Komunikojmë herë pas here.

Gazetari: Z. Meta, zakonisht ka një precedent, edhe pse në Presidencë është shumë më i pakët se në vende të tjera, që çdo person që një detyrë krijon një lloj shpërfillje ndaj paraardhësve. Çfarë raportesh keni ju me ish-Presidentët e tjerë të Shqipërisë?

Meta: Kam respektin më të madh për të gjithë Presidentët e Shqipërisë, jo vetëm për shkak të funksionit të tyre që kanë pasur, por edhe për shkak të raporteve personale që kemi pasur në të gjithë kohën. Unë të vetmin problem si President kam pasur me Doktorin kur ka qenë President, por jo me pas. Pastaj me të gjithë kemi pasur marrëdhënie shumë të mira, edhe shoqërore, edhe njerëzore, edhe me z. Mejdani, edhe me z. Topi, edhe me z. Nishani.

Gazetari: Po me ish-Presidentin e parë pluralist që ka pasur Shqipëria, Ramiz Alinë, edhe pse ai qëndroi thujtë një vit në atë detyrë në vitin 1991-92? A e keni njohur Ramiz Alinë?

Meta: Po, Ramiz Alinë e kam njohur dhe kam pasur herë pas here mundësi për t'u

"Nuk kam asnjë lloj nostalgjie për Enver Hoxhën, Luftën nuk e nisi ai"

Pakti i ri detar? Do të zbatohet vendimin e Gjykatës Kushtetuese

"Me Ramën kam raporte normale, institucionale"

takuar me të, sidomos më 5 maj takoheshim herë pas here me motra e Margarita Tutulanit. Takoheshim ndonjë herë dhe ai ishte një njeri me shumë eksperiencë dhe do të thosha shumë i kthjellët në reflektimin që kishte bërë për të kaluarën.

Gazetari: A mendoni se Ramiz Alia në fund të viteve '80 bëri ç'të mundej që të krijonte një kalim më të butë të pushtetit? Dhe e dyta, a ishte ai po aq fanatik sa Hoxha?

Meta: Me ç'na kanë parë sytë pas 1990-s nuk mund të themi se ai nuk bëri përpjekje të rëndësishme për ta ulur avionin sa më butë në pistën e pluralizmit dhe të demokracisë. Sepse ne shohim një nivel të jashtëzakonshëm të intolerancës edhe sot pas 28 vitesh, është e papranueshme, jo më në atë kohë kur Shqipëria ka qenë në një situatë mjaft të rëndë, edhe ekonomike, edhe sociale për të cilën nuk mund të bëhet përgjegjës thjesht Ramiz Alia si individ, pasi kjo situatë dramatike kishte nisur që me prishjen me Kinën. Kuptohet që në një situatë kaq të polarizuar për shkak të luftës së klasave dhe pasojave mjaft të rënda të saj të një shtresë e madhe e popullsisë dhe të situata ekonomike e tmerrshme, po të kemi parasysh kohën e tonilit e të 80 % dhe të gjithë fenomenet e tjerë, ka qenë mjaft e vështirë për të ecur drejt hapjes dhe drejt demokracisë, pasi ishte akumuluar me të drejtë një mllef shumë i madh.

Gazetari: Z. Meta, herë pas here kam parë t'ju akuzojnë ose kam parë edhe të jeni në gendër të vëmendje për një lloj nostalgjie, po e quaj, ndaj Enver Hoxhës sidomos pranisë së përdorimit të portreteve të tij. Një person që është rritur në Tiranën e viteve '80 ku shumicën e rasteve ishin të paushyqer për arsye të tonilit, ku shihet që vendi ishte në një marrëz të madhe, kur bota po zhvillohej ndërsa Shqipëria ishte krejt e mbyllur, ku parullat absurde dominonin mbi logjikën normale, si mund të ketë nostalgji për Enver Hoxhën?

Meta: Së pari, nuk e di se ku është shprehur këtë nostalgji për Enver Hoxhën. Unë nuk kam asnjë lloj nostalgjie për Enver Hoxhën. Ajo që mund t'ju them është që gjithmonë kam pasur dhe kam një vlerësim dhe nderim për Luftën Antifashiste Nacionale.



lçlirimtare...

Gazetari: E cila nuk ka qenë vetëm e Enver Hoxhës padyshim...

Meta: Jo vetëm që nuk ka qenë e Enver Hoxhës, por kur më pyetën një herë dhe fola për De Gaulle-n, që Franca sidokoftë e kishte De Gaulle-n simbol të rezistencës, dhe më thanë: "Po këtu kush ishte De Gaulle?" Unë thashë: "Ishte Lufta Antifashiste Nacionale lçlirimtare". Më pyetën sërish: "Mos ishte Enver Hoxha? Jo, - i thashë - , nuk ishte Enver Hoxha, për arsye se në rezistenca e Francës ndaj Gjermanisë naziste fillon me De Gaulle, me një figurë mjaft të njohur, që krijoi frontin e rezistencës, në Shqipëri kjo rezistencë ka filluar pa u krijuar as Partia Komuniste dhe pa u njohur as Enver Hoxha.

Gazetari: Ka filluar që ditën që italianët zbarkuan në Shqipëri...

Meta: Dhe më pas Enver Hoxha ishte një produkt i kësaj lufte dhe i mënyrës se si ajo u zhvillua apo qoftë edhe u manipulua në një mënyrë të caktuar. Kështu që nderimi im për LANÇ-in nuk ka asnjë lidhje me ndonjë nostalgji për figurën e Enver Hoxhës.

Ashtu sikurse unë jam i bindur që çdo figurë historike e Shqipërisë duhet parë në kuadër të kohës dhe duhet gjykuar me objektivitet, pasi përndryshe do të fshijmë gjithmonë historinë tonë pa qenë në gjendje për të ruajtur, për të vlerësuar ato gjëra të cilat vërtetë kanë qenë pozitive dhe për të mos përsëritur ato trageditë.

Gazetari: Dhe mbi të

gjitha nuk ka nevojë për pasione politike kur gjykohe historia...

Meta: Unë për këtë kam qenë dhe për këtë jam. Edhe për figurën e Zogut, edhe për çdo figurë tjetër.

Gazetari: Po, ju keni pasur një kontribut sidomos për rivlerësimin e figurës së Mbretëreshës Geraldinë apo të mbretit Zog...

Meta: Edhe Zogu është një figurë që duhet vlerësuar me shumë realizëm, sepse përndryshe do të ishim tepër të njëanshëm dhe nuk do të mësojmë asnjëherë nga historia.

Gazetari: Por bëhet fjalë për figura që ishin anatemuar për 50 vjet dhe gati ishin fshirë nga historia dhe kjo është absurde...

Meta: Sepse në këtë zagon e vazhdojmë edhe sot, që gjithmonë përpigimi të fshijmë çdo gjë të mirë të paraardhësve dhe gjithmonë të krijojmë idenë se çdo gjë fillon nga ne.

Gazetari: Ndërkohë që 2 javë më parë erdhën në atdhe eshtrat e Mid'hat Frashërit, i cili e kishte lënë amanet në një testament, ku kishte dhuruar gjithçka që kishte përfshirë edhe reliket e familjes Frashëri për Shqipërinë dhe kërkonte vetëm të varroset në oborrin e institutit të albanologjisë, për të cilin ai do të kontribuonte për t'u ndërtuar. Si e shihni kthimin e eshtrave të z. Frashëri?

Meta: Mendoj se kjo është një gjë shumë pozitive, sepse çdo shqiptar në fund fare ka të drejtë të prehet në vendin e vet, në atdheun e tij. Në ras-

tin konkret është një figurë komplekse e cila ka kontribute të jashtëzakonshme. Në pak ditë më parë festuam 110-vjetorin e Kongresit të Manastirit. Ai ka qenë një ndër 2-3 figurat kryesore, kryetari i kongresit dhe nënkryetari i komisionit për alfabetin së bashku me Pishën dhe me Luigj Gurakuqin, por edhe me figura të tjera. Jo vetëm kaq, por edhe në Pavarësinë e Shqipërisë ka kontributet e tij, edhe më pas. Sigurisht që angazhimi tij politik apo partiak me Ballin Kombëtar është një angazhim që krijon ndarje, por unë prandaj e theksova më parë që ne duhet t'i vlerësojmë figurat me objektivitet dhe të ruajmë e të çmojmë atë që ata kanë bërë për të mirën e Shqipërisë.

Gazetari: Edhe për momentin duket që kemi një tension me grekët për çështjen e ndarjes së detit dhe kam përshtypjen se pala greke ka drejtuar gishtin nga ju si njeriu që po e pengoni këtë marrëveshje.

Meta: Unë do të theksoj edhe një herë se kam qenë dhe jam tepër i vendosur për marrëdhënie sa më të ngushta sa më miqësore me të gjithë fqinjët dhe padyshim edhe me Greqinë. Dhe unë do t'i bëj shërbimin tim me përkushtimin maksimal kësaj marrëdhënieje edhe me Greqinë, duke marrë përgjegjësitë e mia në radhë të parë në respekt të Kushtetutës së vendit tim dhe të vendimit të Gjykatës Kushtetuese. Kështu që nuk shikoj asnjë arsye...

Gazetari: Atëherë pse vjen ky pretendim z. Meta që ju po e pengoni marrëveshjen me Greqinë?

Meta: Nuk dëshiroj të merrem me pretendimet e askujt, pasi nuk dua të bëhem pjesë e spekulimeve dhe as e përpjekjeve për të kompleksuar Presidentin e Shqipërisë, që të respektoj Kushtetutën e vendit të tij dhe interesat kombëtare të vendit tim.

Gazetari: Jeni i bindur deri në fund për të respektuar këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese për çështjen e detit?

Meta: Më duket se jam tepër i qartë. Unë prirem në këto raporte për të qenë gjithmonë bashkëpunues dhe për të respektuar reciprokisht interesat e përbashkëta.

Rrëfhet modelja: Ja si jam ndjerë kur bashkëpunova me "Dolce Gabanna"

Alesia Noka:

Nuk do heq dorë nga modelingu për asnjë shumë të caktuar

"S'e kornizoj njeriun ideal"

Egla Xhemali

Bukuria e fytyrës zbehet nëse mungon ajo e shpirtit. Alesia Noka është modeli i bukuroshes që karakterizohet nga shpirti plot ngjyra. Ajo është një nga modelet më IN të momentit. E njohur për bashkëpunimet me brandet ndërkombëtare dhe suksesin e jashtëzakonshëm me "Dolce Gabanna"-n, Alesia vjen si rrallëherë në një rrëfim për "Gazeta shqiptare", për setet e veçanta fotografike, paragjykimet ndaj femrave të bukura, për sekretin e të qenit gjithmonë në formë dhe për shumën që do ta tundonte për të mos pasur lidhje me modelingu. Më tej, Noka zbulon se është duke pozuar në Budva për një brand të famshëm. E pyetur se çfarë duhet të ketë një mashkull për të tërhequr vëmendjen e saj, bukuroshja pohon se nuk i pëlqen ta kornizojë njeriun ideal.

Vëzhgimet dhe modelingut në Shqipëri?

Vitet e fundit nuk ka më vështirësi si më parë, sepse klientët janë më të mësuar me tregun dhe me pritshmëritë e modeleve profesionale.

Mendon se paragjykojnë femrat e bukura?

Paragjykimi nuk është vetëm për femrat e bukura. Mendoj se çdokush paragjykohet ashtu si dhe ato pak më të bukurat ose dhe meshkujt. Gjithkush paragjykohet.

Seti fotografik që do e përsërisje?

Fushata e parë për linjën klasike "Tarik Ediz".

Aktualisht je në Budva. Impresionet e tua për setin që po zhvillon atje?

Sot po fotoformojmë për një brand bridal "Nila Style". Jam shumë e kënaqur për faktin që është një ditë shumë e ngrohtë. (qesh)

Më mirë photoshooting apo pasarella?

Photoshooting sepse materialet e përfutuara qoftë ato artistike apo monetare janë më të mira.



Cili është sekretet që je gjithë kohën në formë?


Mendoj që është genetikë, por dhe me ushqimin nuk abuzoj.

Shuma që do të tundonte për të hequr dorë nga modelingu?

Nuk do të hiqja dorë kurrë nga modelingu për një shumë të caktuar, madje nuk e çoj ndonjëherë në mendje. Thjeshtë një punë me një pagesë që nuk do e mendoja të arsyeshme për mua nuk do e pranoja.

Profesioni juaj ka më shumë miq apo armiq?


Pa diskutim që miq. Udhëtimet e shumta dhe eksperimentat e ndryshme që kaloj më kanë bërë të njoh njerëz nga fusha të ndryshme dhe kam kaluar gjithmonë bukur



me ta. **Çfarë duhet të ketë një mashkull që të tërheqë vëmendjen e Alesias?**

Asgjë specifike. Nuk mund ta kornizoj njeriun ideal. **E synon tregun ndërkombëtar?**

Kur kam qenë e vogël, por tani që e kam prekur jam shumë e lumtur me punët e njëpasnjëshme nga vendet e botës. Do veçoja bashkëpunimin me brandet ndërkombëtare "Dolce Gabanna" & "Tarik Ediz".



Stine paska një talent që s'e paskemi ditur, ja për çfarë bëhet fjalë

Stine është një ndër këngëtarët shqiptarë me shumë vite në skenë dhe i ka dhuruar disa hite publikut tonë. Ai është me të vërtetë një këngëtar i talentuar, por nuk e dinim që i bie kaq bukur



violinës. Përmes një videoje në 'Instagram', ku shihet bashkë me një mikun e tij, Stine tregon se është profesionist i violinës. "Kur s'ke çfarë bën në studio i biem ndonjëherë në qafë edhe violinës", shkruan këngëtar i ndërkohe që improvizon me violinë këngën e Elvana Gjatës me titull "Xheloz".



Luana Vjollca ka vendosur t'u habitë, shihni ç'ka paralajmëruar moderatorja

Moderatorja Luana Vjollca është shfaqur ndryshe nga java në javë para publikut që e ndjek në emisionin e saj. Herë bionde, brune dhe madje dhe me flokë të kuqe, siç nuk e kishim parë prej vitesh. Luana Vjollca këtë të shtunë i rikthehet normalitetit dhe duket mjaft sexy me veshjen e saj. Edhe këtë fundjavë ajo u ka premtuar argëtim fansave të saj me videon e postuar. Theksojmë se bukurshja është një nga personazhet më IN të momentit.




Xhensila "i ngrin" gjakun Besit, mësoni si ka reaguar aktori

Jemi mësuar gjithnjë që aktori i humorit Bes Kallaku të krijojë situata humori ku të shpërthejnë të qeshurat, madje edhe duke i vendosur shpeshherë të tjerët në siklet. Por këtë herë duket se bashkëshortja e tij Xhensila Myrtezaj ka marrë "hak"



për herët që Besi mund të ketë bërë shaka me të. Ndërkohë që ishin duke u përgatitur për koncertin e radhës në një storie të publikuar nga Xhensila shohim se ajo hyn pa u ndjerë në dhomën e tyre dhe e tremb Besin, i cili ishte i shtrirë në divan duke lundruar në internet. Reagimi i Besit ka qenë vërtet epik pasi është trembur aq shumë sa i ka rënë telefoni nga dora. Ndërkohë këngëtarja nuk ka mundur të mbajë të qeshurat nga ky reagim i bashkëshortit të saj



U përfol shumë për lidhje, zbulohet kush është moderatorja shqiptare e dashuruar me Dj Sardin

Në tetor të vitit të kaluar, doli lajmi se Dj Sardi ishte ndarë nga balerina e njohur e Tv Klan, Jora Hodo. U përfol se një kontratë pune në Amerikën Latine e Jorës prishi marrëdhëniet mes tyre, mirëpo, Sardi tashmë ka nisur një lidhje të re. Sipas 'Iconstyle', Dj i njohur shqiptar është në një lidhje me moderatoren e njohur të Digitalb, Jonida Vokshin. Çifti ka pak muaj që janë bashkë dhe tashmë gjërat janë bërë zyrtare, pasi ata janë parë në një lokal në kryeqytet bashkë me nënën e Jonidës.



Fuqizohet dekreti, Italia ashpëron masat për emigrantët

Ligji për të huajt, rrezikohet dëbimi i 20 mijë personave nga 25% që kishin fituar azil

Parlamenti italian shndërroi në ligj dekretin e ministrit të Brendshëm Mateo Salvini, ditën e djeshme. Ky ligj ashpëronte masat kundër emigrantëve të jashtëligjshëm, në fuqi prej shtatorit. Ndërkaq ligji i ri parashikon procedura të përshpejtuara dëbimi drejt vendeve të origjinës, veçanërisht për azilkerkuesit që kryejnë vepra penale. Azil do t'u jepet vetëm atyre që u rrezikohet jeta në zona lufte apo per-

MATEO SALVINI

"Lega dhe qeveria po zgjidhin probleme të pazgjidhura prej vitesh. Është një dekret që kufizon biznesin e emigracionit klandestin. Ky ligj i jep më shumë të drejta refugjatëve të vërtetë".

përfituan azil për arsye humanitare vitin e kaluar. Por zv/kryeministri italian ka të tjera argumente në mbrojtje të ligjit. "Lega dhe qeveria po zgjidhin probleme të pazgjidhura prej vitesh. Është një dekret që kufizon biznesin e emigracionit klandestin. Ky ligj i jep më shumë të drejta refugjatëve të vërtetë". Ligji është kri-



Ministri italian, Mateo Salvini

sekutohen politikisht nga qeveritë e vendeve të origjinës. Nga këto ndryshime rrezikohen nga dëbimi të paktën 20 mijë të huaj, 25% e numrit total të tyre që

tikuar ashpër nga demokratët në opozitë, të cilët në shenjë proteste mbuluan fytyrën me maska, që deputetët e shpjeguan me faktin se ky ligj nuk do t'u njohë identitetin dhe fytyrën dhjetëra mijëra emigrantëve që jetojnë e punojnë në Itali.

Incidenti në det me marinarët, Vladimir Putin fajëson Kievin

Merkel kundër zgjidhjes ushtarake mes Rusisë e Ukrainës

Prag lufte? Poroshenko kërkon ndihmën e NATOS-s

Pas rrëmbimit të 24 marinarëve nga Rusia Kancelarja gjermane Angela Merkel është shprehur kundër një zgjidhjeje ushtarake për konfliktin mes Rusisë dhe Ukrainës. Përgjigjja e saj vjen pas kërkesës së Presidentit të Ukrainës, Poroshenko, i cili i bëri thirrje NATO-s të ndërhyjë dhe të dërgojë anije në detin Azov. Tensionet mes dy vendeve u rritën të dielën kur Rusia qëlloi 3 anije ukrainase. Kancelarja Merkel thotë se kjo krizë është shkaktuar krejtësisht nga veprimet e presidentit rus. Megjithatë, ajo shtoi se çështje të tilla duhet të zgjidhen vetëm me dialog dhe jo ushtarakisht. Presidenti Putin ka akuzuar Presidentin ukrainas Poroshenko për provokim lidhur me incidentin që ndodhi në det. Sipas Putin, Presidenti Poroshenko kërkon vëmendjen para zgjedhjeve të vitit 2019 dhe këtë situatë do ta përdorë për politikën e brendshme. Në kundërpërgjigje të agresionit rus, presidenti ukrainas ka vendosur ligjin ushtarak për 30 ditë në pikat kufitare të Ukrainës. Ndërkaq më parë Ukraina ka kërkuar ndihmën e NATO-s për t'u mbrojtur nga Rusia. Në një intervistë për të përditshmen gjermane Bild, presidenti Petro Poroshenko i bëri thirrje aleancës të dërgojë anije luftarake në detin Azov në ndihmë të forcave ukrainase. "Shpresojmë që vendet e NATO-s të jenë të përgatitura për të dërguar anije në detin Azov në mbështetje të Ukrainës dhe të garantojnë sigurinë për ne". Ukraina nuk është pjesë e aleancës së Atlantikut Verior. Poroshenko akuzon Putinin se po përpiqet të ringjallë Perandorinë Ruse dhe ta shndërronë Ukrainën në koloni të saj. "E vetmja gjuhë që Putin kupton është solidariteti i vendeve perëndimore. Politikën agresive të Rusisë nuk mund ta pranojmë. Në fillim ishte Krimea, pastaj lindja e Ukrainës dhe tani ai kërkon detin Azov". Sipas marrëveshjeve të mëparshme mes Ukrainës dhe Rusisë, në ngushticën e Kerçit ku ndodhi incidenti, është i lejuar kalimi i anijeve të të dyja palëve. Por pas aneksimit të Krimesë nga



Kancelarja gjermane, Angela Merkel

PETRO POROSHENKO

"Shpresojmë që vendet e NATO-s të jenë të përgatitura për të dërguar anije në detin Azov në mbështetje të Ukrainës dhe të garantojnë sigurinë për ne. Politikën agresive të Rusisë nuk mund ta pranojmë. Në fillim ishte Krimea, pastaj lindja e Ukrainës dhe tani ai kërkon detin Azov", -ka thënë Poroshenko.

VLADIMIR PUTIN

"Ukraina e provokoi qëllimisht përplasjen. Kjo është përpjekje e presidentit ukrainas, Petro Poroshenko, për të rritur popullaritetin e tij, përpara zgjedhjeve presidenciale që do të mbahen në mars", -ka thënë presidenti i Rusisë, Vladimir Putin.

ANGELA MERKEL

"Kjo krizë është shkaktuar krejtësisht nga veprimet e presidentit rus. Megjithatë, çështje të tilla duhet të zgjidhen vetëm me dialog dhe jo ushtarakisht", -ka thënë ndër të tjera Kancelarja e Gjermanisë, Angela Merkel.

Rusia në 2014-ën, Moska kontrollon edhe hapësirën detare përreth gadishullit. NATO dhe vendet perëndimore mbështesin plotësisht Ukrainën. Por Bashkimi Evropian është shprehur kundër shtimit të sanksioneve ndaj Rusisë pavarësisht

se në Shtetet e Bashkuara po diskutohet kjo alternativë. Ndërsa presidenti i Rusisë, Vladimir Putin, fajësoi Kievin për një konfrontim, në të cilin roja bregdetare ruse hapi zjarr ndaj anijeve të Ukrainës, duke aneksuar tri anije dhe duke kapur dhjetëra marinarë. Putin tha se Ukraina e provokoi qëllimisht përplasjen dhe se ajo është përpjekje e presidentit ukrainas, Petro Poroshenko, për të rritur popullaritetin e tij, përpara zgjedhjeve presidenciale që do të mbahen në mars.

jetëra marinarë. Putin tha se Ukraina e provokoi qëllimisht përplasjen dhe se ajo është përpjekje e presidentit ukrainas, Petro Poroshenko, për të rritur popullaritetin e tij, përpara zgjedhjeve presidenciale që do të mbahen në mars.



Tensionet Rusi-Ukrainë, Trump anulon takimin me Putin

Presidenti i SHBA, Donald Trump, ka anuluar një takim të planifikuar me presidentin rus Vladimir Putin, i cili do të mbahet në Samitin e G20 në Buenos Aires të shtunën. Anulimi i takimit u njoftua nga vetë shefi i Shtëpisë së Bardhë, Donald Trump. Sipas mediave amerikane, anulimi i këtij takimi të parashikuar për të shtunën në Argjentinë është bërë nga tensioni i ndezur mes Rusisë dhe Ukrainës. Trump kishte dyshuar më parë nëse takimi do të zhvillohej, ndërsa në një prononcim për "Washington Post" një ditë më parë, shefi i Shtëpisë së Bardhë deklaroi se gjithçka mund të anulohet, duke cituar si shkak tensionet e anijeve luftarake mes Rusisë dhe Ukrainës. Tre anije të Marinës së Ukrainës u kapën nga Rusia duke u përpjekur të kalonin të dielën midis Detit të Zi dhe Detit Azov. Ndërsa Kievi tha se e kishte njoftuar Rusinë për kalimin, ndërsa Moska zyrtare theksoi se nuk e kishte marrë një informacion të tillë. "Duke pasur parasysh faktin se anijet dhe marinarët nuk u kthyen në Ukrainë nga Rusia, vendosa që të ishte më mirë për të gjithë palët e përfshira që të anulonin takimin e planifikuar në Argjentinë me presidentin Vladimir Putin. Pres me kënaqësi një samit të rëndësishëm sapo të zgjidhet kjo situatë!", shkroi Trump në Twitter.

DONALD TRUMP

"Duke pasur parasysh faktin se anijet dhe marinarët nuk u kthyen në Ukrainë nga Rusia, vendosa që të ishte më mirë për të gjithë palët e përfshira që të anulonin takimin e planifikuar në Argjentinë me presidentin Vladimir Putin. Pres me kënaqësi një samit të rëndësishëm sapo të zgjidhet kjo situatë!", - shkroi Trump në Twitter.

Dialogu për kufirin, Parlamenti Evropian: Rajoni të mos synojë shtete njëetnike

Hyrja në BE, PE: Të liberalizohen vizat për Kosovën

Sholtes: Miratohet Rezoluta për Raportin e Progresit

Ditën e djeshme Parlamenti Evropian i bëri kërkesë Këshillit të BE-së që të lëvizë përpara drejt liberalizimit të vizave për Kosovën. Në rezolutën të cilën e miratoi Parlamenti Evropian, theksohet se tashmë Kosova i ka përmbushur gjitha kushtet e kërkuara për liberalizim të vizave. Në këtë dokument flitet edhe për përparimin dhe ngeçjet që institucionet e Kosovës i kanë bërë drejt progresit të agjendës evropiane. Raporti vë theksin te nevoja e depolitizimit dhe ristrukturimit të administratës publike edhe pse thekson disa përparime që janë bërë në këtë drejtim. Shqetësuese sipas eurodeputetëve mbesin korrupsioni dhe krimi organizuar, fusha këto në të cilat ata kërkojnë përpjekje të përbashkëta për përmirësimin e situatës në këtë drejtim. "Financimi jo i duhur i sistemit gjyqësor, korrupsioni i përhapur, elementet e kapjes së shtetit, ndikimet politike në sistemin e drejtësisë" janë disa prej çështjeve që eurodeputetët i ngrinin si shqetësuese në këtë rezolutë për Kosovën. Ndërkaq Parlamenti Evropian miratoi edhe rezolutën për Serbinë, në të cilën theksohet se janë bërë përparime në reformat ekonomike, por se është më rëndësi thelbësore, të arrihen rezultate të prekshme në reformat në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe



linirin e mediave. Rezoluta mirëpret "angazhimin e vazhdueshëm të Serbisë në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian". Gjithashtu, eurodeputetët përshëndetin përpjekjet që janë bërë për të normalizuar marrëdhëniet me Prishtinën. "Çdo marrëveshje mbi normalizimin e raporteve do të jetë e pranueshme vetëm nëse pajtohen të dyja palët dhe nëse ajo ruan stabilitetin në rajon dhe të drejtën ndërkombëtare" thuhet në rezolu-

lutë. Sa i përket idesë për ndryshim të kufijve, Parlamenti Evropian, thekson se "shtetet etnikisht të pastra nuk duhet të jenë qëllim i rajonit" përdërisa fuqizohet struktura shumetnike e Kosovës dhe Serbisë. Dokumenti i jep rëndësi themelimit të asociacionit të komunave me shumicë serbe në Kosovë dhe zbatimit të gjitha marrëveshjeve ndërmjet dy vendeve përfshirë edhe atë për energjinë. Gjithashtu, parlamenti Evropian ka votuar pro Raportit të Pro-

gresit për Kosovën për vitin 2018. Kjo është bërë e ditur nga Igor Sholtes, raportues për Kosovën në Parlamentin Evropian, i cili edhe ka falënderuar deputetët e parlamentit Evropian për mbështetjen e dhënë raportit. Ai ka publikuar në Twitter një tabelë në të cilën shihet se nga 603 deputetë, 393 kanë votuar pro, 139 kundër, si dhe 71 abstenime. Ndërkohe mediat kanë shkruar se Igor Sholtes ka identifikuar si problem më të mëdha në vend, korrupsio-

nin e madh, krimin e organizuar, dhe mungesën e konsensusit politik në vend. "Çështjet dypalëshe nuk mund të zgjidhen me masa të tepruara", tha Sholtes, duke pasur parasysh taksën 100% që Kosova ka vendosur javën e kaluar për prodhimet nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina. Sholtes, gjithashtu, ishte shprehur se Kosova ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara për liberalizimin e vizave, dhe ka bërë thirrje që BE-ja të kryejë detyrimin e saj.



Haradinaj: Hiqet taksa, nëse njihet Pavarësia

Kryeministri i Kosovës Ramush Haradinaj ka përsëritur edhe njëherë qëndrimin e tij se taksa ndaj mallrave serbe do të hiqet kur të njihet Pavarësia e Kosovës. Ai tha se prodhimi në vend ka qenë sfidë. Haradinaj paralajmëroi se taksa mund të qëndrojë gjatë deri sa Serbia ta njoh Kosovën e të zbatohen marrëveshjet e arritura mes dy vendeve. "Prodhimi është sfidë dhe prodhuesit kanë qenë të sfiduar që nga fillimi. Kosova ka më shumë vetëbesim në prodhim dhe produktet e vendit janë të çmuara. Si qeveri kemi filluar disa punë konkrete, kemi filluar me heq borxheetaksa në raport me vendet e huaja. Veprimet që i kemi ndërmarr në komuna me i jap tokat për krijim të zonave ekonomike janë mundësi reale që prodhuesit tonë ta shohin të ardhmen në vend. Vendi nuk është bërë vetëm për hatër të prodhuesve vendor por është interes i 2 milionë njerëzve që janë në këtë vend. Ju e dini sa keq është trajtuar Kosova dhe produkti 'Made in Kosova'", tha Haradinaj.

603

DEPUTETË

393 kanë votuar pro, 139 kundër, si dhe 71 abstenime për raportin e progresit të PE për Kosovën në vitin 2018 ditën e djeshme në Parlamentin Evropian. Fotoni postoi në Twitter Igor Sholtes, raportues për Kosovën.

8-VJEÇARI SULMOHET DHUNSHËM NGA PESHKAQENI 'PAQËSOR' NË BAHAMAS

Një peshkaqen, pavarësisht se mendohej si paqësor, sulmoi një 8-vjeçar, duke e kafshuar në shpinë. Asher Jones po notonte me peshkaqenin 'nurse' si pjesë e një ekskursioni të organizuar nga Ezuma Cays në Bahama kur një nga predatorët e sulmoi. Babai i djalit, Jeremi, pa peshkaqenin dhe e tërhoqi djalin duke e hequr nga uji. Pavarësisht se peshkaqeni 'nurse' nuk konsiderohet i rrezikshëm për njerëzit, edhe mund të kafshojë. Në fillim sulmit i ishte thjesht babai i tij, i cili po sorollatej gjatë ujit, shkruan Daily Mail.



FOTOLAJM

Kërkohej për korrupsion, ish-kryeministri pritet të dënohet me 2 vite burg

Arratisja e Nikolla Gruevskit, PE amendament për ekstradimin e tij për në Maqedoni

Parlamenti Evropian ka miratuar ditën e djeshme një amendament lidhur me arratisjen e ish-kryeministrit maqedonas, Nikola Gruevski. Në amendamentin e miratuar dhe të dorëzuar nga eurodeputetja Judith Sargentini, Hungarisë i kërkohej që të ekstradojë ish-kryeministrin Gruevski në Maqedoni. Për të shkruar në Hungari ish-kryeministri maqedonas kishte kaluar nga Shqipëria për në Mal të Zi. Ai hyri në Shqipëri nga pika kufitare e Bllatës në Maqellarë të Dibresë në datë 11 nëntor dhe po atë ditë ka dalë nga Hani i Hotit, ndërsa dy ditë më pas është lëshuar urdhri ndërkombëtar i arrestit. Ish-kryeministri maqedonas kërkohej nga autoritetet maqedonase pasi mbi të rëndon një dënim prej 2 vitesh burg për shpër-



dorim detyre. Gruevski akuzohet se bleu një Benz me vlerë mbi 600 mijë euro nga paratë e taksapaguesve maqedonas. Ndërkaq ditën e martë me 62 vota pro, parlamenti i Republikës së Maqedonisë, pa debat, në seancë plenare pranoi rekomandimin e Komisionit për Çështjet e Rregullores, Imunitetit dhe Mandatit për heqjen e imunitetit të ish-kryeministrit dhe deputetit, Nikolla

Gruevski, edhe me kërkesën e gjykatës për shkak të caktimit të masës së paraburgimit. Në seancë nuk morën pjesë deputetët e opozitës nga VMRO-DPMNE-ja, ku Gruevski është kryetar nderi. Ndërkohë, pritet që sot ekstradimi i ish-kryeministrit të Maqedonisë Nikolla Gruevski nga Hungaria, të mbështetet edhe nga shumica e deputetëve të Parlamentit Evropian.

ARTISTI

Plumb në zarf, dhurata e Armando Lulajt për ish-GKA

Fatmira Nikolli


Artisti dërgon me postë një plumb dhe një letër

"Asnjë hapje reale, institucioni është vetëmbyllur"

Një letër që në pamje të parë është e tejkushtë dhe një plumb. Nuk është vetëm (as) një vepër arti. Artisti shqiptar Armando Lulaj i ka dërguar një plumb në zarf dje Muzeut të Arteve të Bukura, ose ish-Galerisë së Arteve Kombëtare në Tiranë. Lajmin e ka konfirmuar vetë ai për "Gazeta Shqiptare". "PLUMB NË ZARF", 2018 ka edhe shpjegimin e vet.

"Si i vetmi institucion i rëndësishëm i artit në vend, Galeria Kombëtare e Arteve, sot Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura, është konsideruar historikisht pikë referimi për artistët vendas, sikundër edhe për publikun. Ndërtesa aktuale, e cila ndodhet në Bulevardin 'Dëshmorët e Kombit', u inaugurua më 29 nëntor 1974, në përvjetorin e çlirimit të vendit. Ky është edhe momenti i parë i riorganizimit dhe ristrukturimit të institucionit, falë të cilin misioni dhe veprimtaria artistike e galerisë vazhdoi shtysën drejt vizionit shtetëror për ndërtimin e të ardhmes socialiste", shënon ai në tekstin që shpërndanë imazhet e zarfit në platformën "DebatikCenter".

Artisti, i njohur për veprat e tij vitet e fundit dhe si përfaqësues i Shqipërisë në Bienalen e Vencias (2015), ka një mesazh që përçon me zarfin e fundit. "Në këtë moment të kohës sonë, kur i gjithë aparatit shtetëror aktual shfaqet mëse i vendosur, që me çdo mjet të lançojë vendin drejt bashkëkohores, institucioni më i rëndësishëm i artit, si pasojë e transformimit të tij në muze, i është nënshtruar një ristrukturimi dhe rindërtimi të dytë. Qëllimi bashkëkohor i lajmëruar prej qeverisë socialiste që prej vitit 2013 nuk ka shfaqur ende e nuk mund të shfaqë kurrësi asnjë shpërthim vizionar, asnjë zgjim, e asnjë hapje reale institucionale. Gjurmët që po lënë pas zbulojnë gjithnjë e më shumë drejtimin e kundërt. Institucioni është ngurtësuar e vetëmbyllur, ndërkohë që shpërthimi i vërtetë ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë jashtë tij", thotë Lulaj. Ai shton se "në këto kohë të demokracisë së paqartë dhe të kontrollit total politik mbi artin, në këtë datë historike të çlirimit të vendit nga nazifashizmi që përkon me përvjetorin e 44-të të inaugurimit të kësaj godine, i dërgova institucionit një copëz të vogël realiteti". Ai e cilëson "PLUMB NË ZARF", një dhuratë për Muzeun Kombëtar të Arteve të Bukura. Ky akt u vulos dhe u siglua më dt. 29 Nëntor 2018, në orën 09:20, dhe ju dërgua Muzeut Kombëtar të Arteve të Bukura, ish-Galeria Kombëtare e



Letra e dërguar nga Armando Lulaj

Arteve, me shërbim ekspres të brendshëm postar me nr. EB756471574AA.

EDUKIM PËRMES HESHTJES

Prej një viti, Galeria Kombëtare e Arteve që me ligjin e ri merr emrin Muzeu Kombëtar i Arteve të Bukura, është vënë në qendër të kritikave, teksa në drejtim është Erzen Shkolli. Duke e vlerësuar emrin e zgjedhur, por pa ditur platformën dhe konceptet e tij mbi institucionin, pas një kohe amullie, pati edhe një kohë kritikash. (E kundërta do të ish-komunizëm) pas disa muajsh heshtje, GKA ose MAB u "rihap" me Edi Hilën, e çka vijoi pas tij, nuk e dha së gjeri idenë e hapjes, pavarësisht cilësisë së ekspozitave. Krejt e kundërta. Edhe në një bisedë me Hilën, artistë të pranishëm shfrytëzuan rastin për të përcjellë pakënaqësitë ndaj Shkolllit dhe ministres Mirela Kumbaro, duke u shprehur se u janë

mbyllur dyert e nuk i pret më njeri. Nëse ishte me vend që kritikak të bëheshin në bisedën e Hilës - ky është tjetër diskutim - por të gjendur pa zë, a të padëgjuar, artistët shfrytëzuan të vetmen mundësi që ju dha. Së fundmi, heshtjes së pothuaj një viti, u është shtuar edhe mbyllja e Ekspozitës Ndërkombëtare "Onufri" - për çka sërish



tografinë. Mbi çfarë ta matim veten? Cilët jemi ne që vendosim pa pyetur dhe nuk kumtojmë çfarë kemi vendosur? Mbi të gjitha, nuk mund zhbëhet një traditë duke u fshehur pas heshtjes. Përndryshe, ky a këta, nuk mund të jenë më institucione të kulturës. Të cilës kulturë? Të asaj që po e zhbëjmë pa pasur guximin të themi pse? Të cilës hapje me Europën? Të asaj që ia cmojmë traditën por nuk e marrim shembull? Dhe nëse ka një plan, për të cilin publiku nuk ka dijeni, pse nuk bëhet publik - siç bëhen publike dhjetëra e evente nën mesataren, vetëm e vetëm pse janë financiar në një masë nga buxheti i ministrisë. As Ministria e Kulturës që deshi ta mbyllte



Qëllimi bashkëkohor i lajmëruar prej qeverisë socialiste që prej vitit 2013 nuk ka shfaqur ende e nuk mund të shfaqë kurrësi asnjë shpërthim vizionar, asnjë zgjim, e asnjë hapje reale institucionale. Gjurmët që po lënë pas zbulojnë gjithnjë e më shumë drejtimin e kundërt. Institucioni është ngurtësuar e vetëmbyllur, ndërkohë që shpërthimi i vërtetë ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë jashtë tij", thotë Lulaj

nuk ka sqarime zyrtare, siç do të duhej të ishte, kur bëhet fjalë për një institucion kombëtar si GKA dhe një ekspozitë tradite si Çmimi "Onufri". As Çmimi "Onufri" e as GKA nuk mund të jenë vendime personale të askujt as të mbeten vullnete personale të askujt. Hapja kulturore që propagandohet, cilësia e eventeve, mesazhi e frytet, përballja me të tjerë, kultura si pasaportë - nuk arrihen me mbylljen e "Onufrit" pas mbylljes së kahershme edhe të çmimit për fo-

"Onufri" edhe dy vite më parë, as GKA, nuk e kanë parë me vend të sqarojnë se çfarë i çoi në marrjen e këtij vendimi dhe në fakt cili është vendimi. Tani, do të duhej të vizitonim ekspozitën e përvitshme ndërkombëtare. Por përtej godinës me suva të rënë, nuk ka asgjë. Qyteti është zbuluar për foto, adresat zyrtare në rrjetet sociale të ngopin me imazhe, por (ç)edukimi përmes heshtjes është ai që po i vret ardhmëritë e priturat. Modernitetin i lëngët!



Kritika për Budinën: Bariu, budallai i shenjtë i filmit të mahnitshëm

Fatmira Nikolli

Dasitë fetare mes anëtarëve të një familjeje në një komunitet malor shqiptar pasqyrojnë ato të vendit në tërësi, të cilat janë të rrëfyera me një fotografi kinematografike të mrekullueshme. Besniku, një bari dhe mysliman i devotshëm është i lidhur shpirtërisht me tokat e egra të vendit të tij, ku endet. Por kur shëndeti i babait të sëmurë përkeqësohet, vëllai dhe motra e tij vijnë në shtëpinë e familjes dhe Besniku e gjen veten në zemër të një konfliktit të zjarrtë. Ndërkohë, zbulimi se xhamia e lashtë e fshatit ishte fillimisht kishë katolike shkaktonte trazira brenda komunitetit dhe më gjerë. Me një kohë të ngadaltë, por me një rrëfim kinematografik të habitshëm, ky film vazhdimisht risjell përplasjen midis traditës dhe modernes, përçarjen mes kulturave të ndryshme lokale, që bashkëjetonin më parë.

Një mesazh i fuqishëm shkon për njerëzit që "e duan Zotin, por nuk arrijnë të duan njëri-tjetrin". Nis kështu kritika e revistës së kushtuar kinemasë "Screen Daily" për filmin e Robert Budinës, "Një strehë mes reve", shfaqur me 28 nëntor në festivalin "Tallin". Drama mes anëtarëve të familjes mund të duket pjesa më e qetë, por nuk ka asgjë të përmbytur kur bëhet fjalë për gjeografinë mahnitëse të vendit ku ndodh ngjarja. "Sfondi i maleve dhe jetët e njerëzve janë fotografuar në mënyrë të shkëlqyeshme dhe për këtë e më shumë, filmi ka të ngjarë të gjejë një audiencë të gjerë në festivale pas shfaqjes së tij në Festivalin e Filmit në Tallin. Përveç këtij peizazhi, filmi gjithashtu ndan shumë nga etnologjia arthouse film - bariu protagonistin një 'budalla' i shenjtë - dhe si i tillë, arrin të krijojë një ndjesi të brishtë brenda vetes", vijon kritika. Për të, Besniku (Arben Bajraktaraj) ka një cilësi, ai di të jetë në harmoni me komunitetin dhe ritmin e natyrës ku ai jeton. Ai gjunjëzohet për t'u lutur në fushë, mes dhive të tij dhe pastaj thjesht zhduket. "Djemtë e fshatit që e spiunojnë atë, janë të hipnotizuar nga ky vetmitar i heshtur, duke ia atribuuar atij fuqitë mbinatyrore që shkojnë përtej lidhjes me natyrën. Dhe është Besniku, i cili, i udhëzuar nga një instinkt që nuk mund ta shpjegojë, ciflos suvanë në murin e xhamisë së vogël dhe zbulon një fragment të një pikturë të lashtë të krishterë. Zbulimi trajtohet me dyshim



Fragment nga filmi "Një strehë mes reve"

Revista e kinemasë "Screen Daily", artikull për filmin "Streha mes reve"



nga vendësit, por shkaktonte shumë reagim në fshat. Vilma, një historiane e artit nga Instituti i Monumenteve, arrin të vlerësojë gjetjen; Besniku është i magjepsur dhe i pavendosur në lidhje me të", - shk-

ruan "Screen Daily". Për të, po aq shqetësuese për këtë njeri të thjeshtë, që di të vlerësojë paqen në jetën e tij, është ardhja e vëllezërve dhe motrave të tij. "Kam një ndjenjë që nuk jeni këtu vetëm

u kthyer në një prej festivaleve më të mëdhenj të Europës Veriore dhe një ndër platformat më të përqendruara rajonale të industrisë së filmit, duke mirëpritur më shumë se 1000 të ftuar dhe përfaqësues të fushës dhe më shumë se 160 gazetarë nga e gjithë bota. Përgjatë ditëve të tij shfaqen rreth 250 filma të gjatë dhe më shumë se 300 filma me metrazh të shkurtër dhe të animuar, duke shënuar një publik prej më shumë se 80 mijë vetash çdo vit. Në vitin 2017-ën festivali është mbuluar në 71 gjuhë të ndryshme të botës me një mesatare të mbulimit mediatik prej 1.1 miliardë njerëz. Ai cilësohet së bashku me Festivalin e Kanës, Venecias dhe Berlinale si ndër 4 më të rëndësishmit në përzgjedhjen e filmave të konkurrimit kryesor. "Doja të realizoja një film intim, personal të marrë një pjesë të trashëgimisë. Djali dhe familja e tij janë konvertuar në besimin ortodoks kur jetonin në Greqi, motra e Besnikut dhe familja e saj janë myslimanë. Ndërsa babai i tij është një komunist i vjetër cinik.

"Nuk zgjat shumë dhe tensionet mes tyre rriten. Besniku i brishtë, i cili është i rrënuar nga konfliktet, të cilat janë paralajmëruar më parë nga muzika dhe të detaje të tjera, për pasojë fillon të tregojë lodhje mendore. I nxjerrë jashtë prej shtëpisë ku vëllai dhe motra konfliktohen, ai ndihet përgjegjës për rritjen e valës së armiqësisë ndërmjet banorëve myslimanë dhe fqinjëve të tyre katolikë, e cila u shkaktua nga lajmi i origjinës së xhamisë. Një mesazh i fuqishëm shkon për njerëzit që "e duan Zotin, por nuk arrijnë të duan njëri-tjetrin", përfundon shkrimi i "Screen Daily".

FILMI

"Streha mes reve" është filmi i dytë me metrazh të gjatë i skenaristit dhe regjisorit shqiptar Robert Budina, që pati premierën e tij botërore në Konkurrimin Zyrtar të Festivalit të Filmit "Tallin Black Nights". Ai vjen si një financim i Qendrës Kombëtare të Kinematografisë në bashkëpunim me RTSH. I themeluar në vitin 1997, "Tallin Black Nights Film Festival" është zgjeruar së shumti duke

për mua", tërheq vëmendjen babai i tij tek djali i madh, i cili e sheh shtëpinë e familjes, si një mundësi për të marrë një pjesë të trashëgimisë. Djali dhe familja e tij janë konvertuar në besimin ortodoks kur jetonin në Greqi, motra e Besnikut dhe familja e saj janë myslimanë. Ndërsa babai i tij është një komunist i vjetër cinik. "Nuk zgjat shumë dhe tensionet mes tyre rriten. Besniku i brishtë, i cili është i rrënuar nga konfliktet, të cilat janë paralajmëruar më parë nga muzika dhe të detaje të tjera, për pasojë fillon të tregojë lodhje mendore. I nxjerrë jashtë prej shtëpisë ku vëllai dhe motra konfliktohen, ai ndihet përgjegjës për rritjen e valës së armiqësisë ndërmjet banorëve myslimanë dhe fqinjëve të tyre katolikë, e cila u shkaktua nga lajmi i origjinës së xhamisë. Një mesazh i fuqishëm shkon për njerëzit që "e duan Zotin, por nuk arrijnë të duan njëri-tjetrin", përfundon shkrimi i "Screen Daily".

Filmi është financuar nga QKK dhe prodhuar nga producentja Sabina Kodra (Era film) në bashkëpunim me RTSH dhe Cristian Nicolescu, Rumani (Digital Cube). "Streha mes Reve" u xhirua nga drejtori i fotografisë së Radu Jude, Marius Panduru (i cili gjithashtu ka xhiruar filmin "Album", triumfues në festivalin e filmit të Sarajevës në 2014), montazhier ?tefan Tatu (Wolf) dhe Kompozitor Marius Left?rache. Kastë filmik për-bëhet po ashtu nga Esela Pysqyli, Irena Cahani, Bruno Shllaku dhe Osman Ahmeti dhe të drejtat ndërkombëtare trajtohen nga distribucioni gjerman i "Pluto Film". Filmi do të ketë premierën në Shqipëri në datën 13 dhjetor 2018.

TE DHENA

Shtëpia Filmike - "Era film"
Shitjet ndërkombëtare - "Pluto Film"
acquisitions@plutofilm.de
Producent: Sabina Kodra
Skenarist: Robert Budina
Montazh: ?tefan Tatu
Dr. Fotografie Marius Panduru
Musika: Marius Left?rache
Kastë kryesor: Arben Bajraktaraj, Esela Pysqyli, Irena Cahani, Bruno Shllaku, Osman Ahmeti

Opinioni *i* Ditës

BE dhe SHBA po nxisin kaos në Ballkan

Jasmin Mujanovic

(vijon nga faqja 1)

... parashtruar dy vjet më parë: se projekti euroatlantik në Ballkan është drejt fundit të vet.

Merrni parasysh historitë: Nikola Gruevski, ish-kryeministri i Maqedonisë, i dënuar kohë e fundit për akuzat korruptive, është larguar nga vendi në prag të burgosjes së tij dhe ka kërkuar azil në Hungari; Kosova ka imponuar tarifa të ashpër importesh për Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën; dhe Milorad Dodik, anëtari i sapozgjedhur serb i presidencës trepalëshe të Bosnjës, ka deklaruar se do të përdorë pasaportë serbe dhe jo boshnjake për udhëtimet e veta zyrtare.

Fije që i bashkon këto zhvillime është se ka rënë çdo pretendim se Ballkani Perëndimor drejtohet nga rendi i bazuar në rregulla.

Duke qenë se e kanë kuptuar edhe vetë këtë, elitat vendase po janë gjithnjë e më të furishme në konfrontimet e tyre me BE dhe SHBA.

Ata janë të bindur se kjo është një strategji efektive për të nxjerrë përfitime nga institucionet diplomatike të pakudësishme në Bruksel dhe Uashington, të cilët janë të etur vetëm për të ruajtur iluzionin e stabilitetit rajonal.

Çështje më e rëndësishme, elitat vendase e llogarisin këtë si një strategji të shëndoshë për t'i bërë përshtypje edhe bamirësve të tyre të rinj post-perëndimorë; Rusisë, Kinës, Turqisë dhe monarkive të Gjirit.

Disa mund ta shohin si hiperbolë sugjerimin se rendi i bazuar në rregulla (padyshim i dobët) në rajon është shembur. Por le të vlerësojmë faktet.

Elitat si Gruevski dhe Dodik plaçkitin, fyejnë dhe shkelin sipas dëshirës, pastaj i largohen ndonjë sanksioni ose pasojave të veprimeve të tyre nga institucionet lokale ose ndërkombëtare.

Ndërkohë, Kosova ka humbur besimin në kapacitetin e BE-së për të integruar vendin në bashkësinë europiane të shteteve. Si rezultat i kësaj, Prishtina po zbaton të gjitha llojet e politikave dikur heretike, nga luftërat tregtare në marrëveshjet e ndarjes.

Dhe pse shumë është folur për të ilustruar pse propozimi i fundit do të ishte një kthesë katastrofike për të gjithë rajonin, ai vazhdon të jetë pjesë e një fenomeni ekzistues - rënies së legjitimitetit politik të Perëndimit në Ballkan dhe kthimit drejt marrëveshje alternative nga elitat vendase.

Këto marrëveshje alternative



janë një tipar i regjimeve autoktone dhe tyre autoritare të mbështetur nga liberalë të huaj.

Asnjë prej tyre nuk i ngjan ndonjë gjëje që mund të shihet si "europiane", domethënë demokratike, siç ka qenë dhe mantra e Ballkanit Perëndimor për gati dy dekada.

Natyrisht, ngjarjet në këtë rajon janë thjesht pjesë e krizës më të gjerë të liberalizimit ndërkombëtar që është bërë veçanërisht i theksuar që nga fillimi i agresionit të Rusisë në Ukrainë, Brexitit të Mbretërisë së Bashkuar dhe rrethanave të qarta në SHBA.

Megjithatë, vendet e Ballkanit nuk janë thjesht viktime të këtij riorganizimi politik global. Elitat e rajonit janë agjentë, megjithëse të vegjël që manipulojnë ngjarjet ndërkombëtare për të mirën e vet.

Si gjithmonë, viktimat janë qytetarët e zakonshëm të rajonit. Diplomatët europianë dhe amerikanë mund të vazhdojnë të shërbejnë në sipërfaqe, por asnjë ndihmë kuptimplotë nuk është në horizont.

Pavarësisht nëse referohet si ndihmë për demokracinë, shtetndërtim ose zgjerim, ideja e promovimit të qeverisjes së mirë jashtë vendit nuk ka më vend përballë impulseve të nativistëve të rrjedhës së re populiste të Perëndimit.

BE dhe SHBA nuk janë palë të

pa interesuara në trazirat e Ballkanit. Sfaqja e Gruevskit në Hungari, një shtet anëtar i BE-së, implikon drejtpërdrejtë Brukselin si një palë, ose të paktën një mundësues, ndaj sulmit mbi sundimin e ligjit në Maqedoni dhe rajon.

Nëse BE nuk siguron menjëherë kthimin e Gruevskit në Shkup, kjo do të ishte një goditje për praninë e saj tashmë shumë të keqe në rajon.

Ndëshkimi me tarifa nga ana e Kosovës, ndërkohë duhet të njihet si një akt dëshpërimi. BE ka kënaqur sabotazhin e Serbisë për aspiratat legjitime të Kosovës për njohjen ndërkombëtare, së fundmi duke i mohuar vendit një vend në INTERPOL.

Duke vepruar kështu, ajo ka udhëhequr në mënyrë efektive radikalizimin e klasës politike të vendit, të cilët kanë arritur në përfundimin se sjellja e mirë fiton vetëm lëvdata retorike, jo ndihmë aktuale nga europianët.

Në një farë pike, BE-ja duhet të vendosë nëse duhet të veprojë me drejtësi dhe në këtë mënyrë të rrezikojë të shkaktojë zemërimin e aktorëve të caktuar, ose të vazhdojë të pretendojë se nuk po i kupton realitetet në terren dhe kështu ta humbë besueshmërinë e saj të të gjitha palëve e përfshira.

Kosova është shembulli më i spikatur i zgjedhjes që duhet

bërë, por situata në Bosnjë është pak më e mirë.

Provokimi me pasaportë të Dodik është më i fundit nga gjithë tekat.

Megjithatë, nuk është thjesht teatër. Kjo ngjarje duhet të shihet si përpjekje e tij për të krijuar defakto një sundim njëpartiak në entitetin e Bosnjës në Republikën Srpska dhe dështimin e partisë së tij për të ndryshuar kushtetutën e njësisë, për të militarizuar policinë, për të rekrutuar paraushtarakë të trajnuar në Rusi dhe për të krijuar struktura paralele të sigurisë duke ruajtur lidhjet diplomatike jo vetëm me Rusinë dhe Serbinë, por me territoret të pushtuara si Osetia e Jugut.

Këto nuk janë lojëra, kjo është themeli për shpëputjen. Në shumicën e shteteve të tjera, Dodik do të ishte dënuar me kohë për tradhti. Por, për shkak se është në Bosnje, ai vazhdon të përdorë fondet e taksapaguesve boshnjakë për të minuar shtetin boshnjak, ndërsa BE dhe SHBA bëjnë një sy qorr.

Për fat të keq, së shpejti situata do të jetë e pamundur për t'u shpërfillur. Me këtë ritëm nuk do të duhet shumë kohë që nisim të flasim për zvetënimin e projektit euroatlantik në Ballkan.

Atëherë do të jemi duke u përpjekur të gjejmë kuptimin e pasojave shtakërrimtare.

Marrë nga Balkan Insight

HOROSKOPI

DASHI

Mos undikoni nga negativiteti i të tjerëve dhe mos bini preh e provokimeve cinike të dikujt pranë jush. Lejoni të tjerët të mendojnë dhe të thonë çfarë të duan. Bëni mirë të qetësoheni dhe t'i ktheheni punës suaj. Paspune bëni mendoni për diçka argëtuese për tu ndjerë të relaksuar.

DEMI

Mos ia lejoni vetes që të mos përkushtoheni sot në punë. Gjithashtu, mos refuzoni ftesën për të shkuar në një takim të rëndësishëm. Do të gjeni kohë për të realizuar një mbërmbje të këndshme me partnerin/partneren.

BINJAKET

Do të keni një axhendë të ngarkuar sot dhe do të jetë e vështirë për ta përballuar. Do t'ju telefonojë dikush, që do t'ju thotë diçka shumë të rëndësishme, duke ju shpërqendruar nga puna. Nëse keni ndërmend të bëni një aventurë të rrezikshme, nuk do të ishte ide aspak e mirë.

GAFORJA

Do t'ju vijë një dhuratë e çuditshme, e cila do t'ju ndërrlikojë ditën. Megjithatë, përpiguni të mos e ofendonin personin që ua dërgoi. Ka gjasa që të planifikoni disa ditë pushimi me personin tuaj të zëmërës.

LUANI

Gjendja juaj financiare do të jetë e kënaqshme sot. Do të kryeni disa detyra shumë të rëndësishme, të cilat u kanë munduar prej kohësh. Në mbërmbje do të shkoni në një event shumë të veçantë dhe do të takoheni me persona që iu pëlqejnë komunikimi.

VIRGJERESHA

Ka gjasa të përballeni me disa probleme financiare. Megjithatë, mos u shqetësoni, pasi kjo situatë mund të përmirësohet shumë shpejt. Mendohuni mirë përpara se të ndërmerrni një vendim të rëndësishëm për jetën tuaj personale.

PESHORJA

Kokëfortësia do t'ju ndihmojë sot. Mos u tërhiqni nga parimet dhe zakonet tuaja. Mbroni interesat tuaja ndaj çdoqut që përpigjet t'ju prekë lirinë. Në pjesë të tjera të jetës do të mbizotërojnë qetësia.

AKREPI

Përpiguni të mbani veten nën kontroll dhe të mos nervozoheni. Realizoni vetëm ato gjëra që janë të rëndësishme për ju. Për çështje të tjera do të keni kohë mjaftueshëm të merreni ditën në vijim. Qëndroni larg zhurmës dhe grupeve të mëdha me njerëz.

SHIGJETARI

Do të zgjidhni një problem që iu ka shkakuar shumë stres kohët e fundit. Megjithatë, nuk do ta arrinit këtë pa ndihmën e miqve. Nuk është momenti për të kryer ndryshime rrethësore apo për veprime spontane në jetën tuaj personale.

BRICJAPI

Mos u nxitoni në marrjen e vendimeve, pasi ka gjasa të bëni gabime, të cilat nuk mund t'i regulloni. Mendoni me kujdes dhe kërkoni këshillat e familjarëve, pasi do t'ju ndihmojnë pa masë. Do të kaloni një mbërmbje të këndshme, e cila do të jetë e mbushur me romanticitet.

UJORI

Do të kryeni disa biseda shumë të rëndësishme sot. Bëni mirë të dëgjoni me kujdes bashkëbiseduesit dhe të analizoni çdo fjalë të tyre. Ka gjasa që të ofendonin një familjarin tuaj, i cili nuk do të ngurojë ta shprehë mërzitjen ndaj jush.

PESHQIT

Mund të merrni një lajm shokues, që nuk do t'ju besohet. Në fakt, ky lajm nuk ka lidhje me ju personalisht, por me një mikun/miken tuaj. Sa i përket jetës suaj personale, nuk ka dilema. Do të kaloni një mbërmbje të këndshme me miqsh, të organizuar në shtëpinë e njërit prej tyre.

DERBI NË SHIFRA

Partizani-Tirana, derbi i madh i kryeqytetit nuk vjen ashtu siç tifozyt e futbollit shqiptar do të dëshironin ta shihnin. Natyrisht kjo për faktin se skuadrat po jetojnë realitetin të ndryshme. Të kuqtë janë në valë për titull, kryesojnë me meritë dhe duelojnë prej javësh me Skënderbeun, ndërsa Tirana që prej rikthimit në Superiore, është e përfshirë në luftën për mbijetesë, duke zhgënjyer

pritsmëritë e mëdha të tifozërisë saj. Partizani është i pari në tabelë me 31 pikë pas 14 javësh kampionat, Tirana e teta me 11 pikë, 20 më pak sesa rivalët e përgjeshëm. Të kuqtë e Skënder Gegës janë ekipi që ka shënuar më shumë fitore deri më tani, plot 10, ndërsa bardheblutë kanë fituar vetëm dy herë, të dyja në epokën Ze Maria, ndërsa Ardian Mema vijon të jetë në kërkim të suksesit të parë. Sulmi mes skuad-

rave nuk ka ndonjë diferencë të frikshme. Partizani ka shënuar 15 gola, ndërsa Tirana 12, por ajo që bën diferencën është prapavija. Partizani është mbrojtja më e mirë e kampionatit me vetëm 6 gola të pësuar, ndërsa Tirana ka në arkivin e saj 17 gola të pësuar, çka ka reflektuar dhe ecurinë e dy ekipeve deri më tani. Bardheblutë nuk fitojnë praj 7 javësh, ndërsa "demat" ndërpreu serinë prej 3 fitoresh radhazi me humb-

Partizani-Tirana, diferencat janë të mëdha, por fusha i zeron

jen e javës së shkuar në Vlorë, teksa në derbi do të kërkojë të rikthehet të suksesit. Gjithsesi derbi nuk është një ndeshje, është ndeshja, dhe kur skuadrat do të zbrisin në fushën e blertë, këto diferencat të mëdha do të zërohen pasi të dyja ekipet do të luftojnë për kre-

narinë e tifozëve. Skënder Gega do të ketë në dispozicion të zgjedhë më të mirët. Asnjë pezullim nuk rëndon në kampin e kuq, ndërsa pritet të rreshtohet nga minuta e parë e njëjta skuadër që luajti në Vlorë ndaj Flamurtarit. Nga ana tjetër Ardian Mema do t'i besojë ekipit që

barazoi me Skënderbeun, por duhet të zëvendësojë Bedri Grecën e kualifikuar, me teknikun bardheblu që ka ndërmend të spositoje Sentamun në krahun e majtë duke zvendosur Hasanin në majtë të sulmit dhe Mavejen në krahun e djathtë. Gjithsesi një alternativë e vlefshme është edhe Blazhevski, por detajet e fundit do të përcaktohen vetëm përpara takimit të së premtes.

Tirana ka luajtur mirë, por i ka munguar sukcesi, sukses që e duan ndaj Partizanit sot

Mema: Jemi të karikuar, mungesa e Hoxhës, pozitive
Trajneri bardheblu shpreson të gëzojë tifozët e tij



Jeton Selimi

Ardian Mema kërkon fitoren e tij të parë në krye të Tiranës dhe këtë kërkon ta bëjë pikërisht në derbin e madh të kryeqytetit. Partizani është kryesues ndaj përballja është e vështirë, por për trajnerin bardheblu kjo do të ishte sfida e duhur për të ndryshuar sezonin e Tiranës, që deri më tani ka qenë larg pritshmërive. Në konferencën e fundit për shtyp në prag të sfidës së sotme, Ardian Mema e shikon si një bonus për të tijtë mungesën e portierit dhe kapitenit të kuq, Alban Hoxhës.

Do të donit Partizanin në debutim, por a është momenti i duhur?

E thashë edhe kur erdha këtu, pasi doja të jepja një mesazh për lojtarët. Dua të bëj ndeshje të forta, si derbi. Është një takim me historik të madhe, edhe kur kam qenë futbollist i doja ndeshje të forta.

Është gati Tirana?

Çdo gjë varet nga futbollistët, por edhe nga unë. Bashkë me lojtarët e shohim si ndeshje të radhës, edhe pse ka peshën e vet. Duhet të bëjnë detyrat si në çdo ndeshje. Karikimi nuk mungon. Edhe Partizani vlen 3 pikë, si çdo ndeshje tjetër.

Ultrasët kanë deklaruar bojkotin e ndeshjes.

Që kur kam lënë futbollin, tifozët kanë dhënë spektakël dhe ne nuk e kemi shijuar. Më shumë ka pasur spektakël në shkallë. Ata kanë luajtur më mirë se lojtarët, shpresojmë që spektakli të jetë në fushë.

Do të ketë ndryshime formacioni?

Ka ndryshime të vogla. Mbrojtja do të jetë njësoj, por mund të lëvizim gjatë lojës. Po të shikojmë golin ndaj Skënderbeut e pësuam në goditje standarde. Aty marrin pjesë edhe mesfusha edhe sulmi. Ishte vendosje jo e mirë.

Presioni është te Parti-



zani, a favorizohet Tirana?

Çdo futbollist ka peshën

e vet. Hoxha është ndër portierët më të mirë. Ky presion është te Partizani,

u mungon një titullar. Duhet të veprojme mirë përpara portës, goftë me Albanin apo tjetrin. Kjo është pjesa ime e punës, duke marrë në konsideratë kush luan në portë.

Do të preferonit lojë të keqe dhe fitore?

Nuk ka asnjë trajner që dëshiron që ekipi të mos luajë mirë. Kemi bërë mirë lojë, por nuk mjafton. Pres rezultate, dhe futbollistët. U bë kohë e gjatë pa fituar. Na ka munguar, do të ishte kënaqësi po të fitonim.

Çfarë kenit menduar për sulmin?

Nuk e kam deklaruar si do të luaj dhe ju nuk mund ta dini. Strategjia është ndryshe për çdo ndeshje. Nuk mund të them se si do të sulmojmë. Puna e tra-

nerit është ta çojë ekipin deri te porta. Me këtë gjë kam punuar.

Ndërkohë mbrojtja ka çaluar.

Në futbollin e sotëm është i rëndësishëm grupi. Një lojtar analizohet edhe në lëvizjet që bën individualisht, në repart dhe në bllok. Në janar mund të shikojmë për lojtarë të tjerë. Kemi nisur të shohim, por kjo s'do të thotë presion për lojtarët e tjerë. Duhet konkurrencë, kush ta meritojë të luajë. Fanellën nuk ta jap Ardian Mema.

Nëse barazoni komplikohet situata?

Dëshira është të fitojmë, por futbollin i nuk e parashikoj dot si del ndeshja nesër (sot).

ISH-KAPITENI I SKËNDERBEUT



Shkëmbi rikthehet në Korçë si kundërshtar

Blendi Shkëmbi rikthehet në Korçën e tij, kësaj radhe si kundërshtar. Ish-kapiteni dhe lideri i Skënderbeut të suksesshëm, e ndërpreu karrierën e tij si futbollist një sezon më parë për t'iu përkushtuar asaj të trajnerit, fillimisht te Liria e Prizrenit dhe sot te Teuta. Pikërisht në krye të durrsakëve, Shkëmbi i shkaktoi humbjen e parë Skënderbeut në javën e gjashtë të kampionatit dhe që u lejoi bregdetarëve të rifillon me pas ringritjen, ku në 8 javët e fundit kanë koleksionuar 5 fitore, dy barazime dhe një humbje, humbje që erdhi ndaj Partizanit kryesues. Pra, me pak fjalë, Teuta arriti të krijojë një identitet të sajën, çka e katapultoi në vendin e tretë të renditjes me 25 pikë, 5 më pak sesa Skënderbeu i vendit të dytë, ndaj të cilit do të ndeshet ditën e shtunë në Korçë, një sfidë e gjitha për t'u shijuar, pasi edhe skuadra e Orges Shehit, durrsakut që është në krye të kampionëve, dhe që do të kërkojë, gjithashtu, sikundër edhe Bledi Shkëmbi, suksesin ndaj qytetit të tij.

Renditja e Fifa-s, kryeson Belgjika

Shqipëria mbetet e 60-ta, Kosova ngjit 6 vende.

Shqipëria vijon të mbetet në vendin e 60-të në renditjen e Fifa-s dhe për muajin nëntor. Kuqezinjtë zhvilluan dy sfida në këtë periudhë, atë ndaj Skocisë, ku u mposhtën 4-0 dhe suksesin ndaj Uellsit me fitoren 1-0. Padyshim që renditja tregon dhe formën e kuqezinjve, që në këtë edicion të Ligës së Kombeve kanë vijuar me paraqitje jo të mira duke qëndruar larg performancave që e ngjiten Shqipërinë në rekordin e saj historik.

Vijon ngjitjen Kosova. Dardanët kanë fituar 6 pozicione dhe tashmë gjenden në vendin e 136. Padyshim që këtu kanë ndikuar fitoret ndaj Maltës dhe Azerbajxhanit, që i lejuan Kosovës të ngjitet në Ligën C, aty ku bëjnë pjesë dhe kuqezinjtë.


Sa i takon kreut të renditjes, Belgjika vijon të mbajë vendin e parë, e ndjekur nga Franca dhe Kroacia. Jash-të 10 vendeve të para Gjermania, me skuadrën e Lëvit që ka humbur sërish 2 pozicione dhe ka zbritur në vendin e 16-të

Vlonjatët duan fitoren e dytë radhazi

Flamurtari do të kërkojë vazhdimësinë ndaj Kastriotit

Flamurtari kërkon të bëjë bis fitoresh ndaj Kastriotit. Kuqezinjtë e Ilir Dajës do të udhëtojnë këtë fundjavë në Fushë-Krëjë për t'u përballur me krutanët e vendit të fundit, ndërsa vlonjatët do të kërkojë të kërkojnë të rrisin serinë e fitoreve, që nisi të premtën e shkruar ndaj Partizanit. Në fakt, vazhdimësia ka qenë problemi më i madh për formacionin e Ilir Dajës në këtë edicion. Hera e fundit që kuqezinjtë kanë arritur dy fitore radhazi ka ndodhur në javën e dytë ndaj Kukësit dhe në javën e tretë ndaj Luftëtarit, të dyja fitore me të njëjtin rezultat 1-0, më pas, që prej 1 shtatorit, vlonjatët kanë nisur një seri ndeshjesh jo bindëse, me dy humbjet ndaj Skënderbeut dhe Partizanit për t'u rikthyer të suksesit në javën e gjashtë ndaj Kastriotit, më pas tre pikë ndaj Tiranës në javën nëntë, fitorja ndaj Kukësit në javën e 11-të dhe trepikëshi i fundit ndaj Partizanit në javën e 14-të. Kjo thyerje e vazhdueshme rezultatesh ka bërë që Flamurtari të jetë në vendin e gjashtë me 22 pikë, 9 më pak sesa Partizani kryesues, ndërsa duket se Kastrioti vjen pikërisht në momentin e duhur për kuqezinjtë, që do të synojnë të krijojnë një vazhdimësi me shpresën për të ngushtuar diferencën me dyshen e kreut dhe për t'u rikthyer edhe njëherë në pretendimet madhore të fillimsezonit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

1. Emri i Monet.
8. Një top në rrjetë.
11. Carl Edward, që shkroi Contact.
12. Qe bukuroshi që u hidhte ferë përdëvive.
15. Qe era hyjnoreja e japonezëve.
16. Një pjesë e lartësive.
18. Muzikanti që... nuk përsëriste.
20. Lumë në Rusi.
21. Eshhtë i lartë ai i kampionit.
22. Kalifi që themeloi Kairon.
24. Kështu e quajti Krishti shën Pjetrin.
25. Janë në guvë.
26. Ilioni portier.
27. Markë makine.
28. Ashtu si duhet të përgjigjet fituesi.
29. Inicialet e Mann.
30. Një parabolë e tenisist.
31. Fillojnë tatepjetjen.
32. Ente Autonome.

33. Jean, që solli duhanin në Europë.
 34. Mund të jetë dëshmor.
 36. Pak stabilitet.
 37. Arturo i Brecht.
 39. Një pjesë e onkologjisë.
 40. Mbyllin një shtëpi.
 41. Të parat në stafetë.
 42. Qe profet i vogël.
 45. Me break në tenis.
 46. Mbyllin një sirtar.
 47. Qe perëndesha që lindi Arionin.
- VERETIKAL**
1. Inicialet e Santana-s, kitarist.
 2. Nota e diapazonit.
 3. Eshhtë frika nga shehet e hapura.
 4. Diftong në duar.
 6. Qe libri erotik i Mallanaga Yatsyayana-s.
 7. Lauda ish-pilot i Formula 1.
 8. Janë lotët që gjithkush i derdh me kënaqësi.
 9. Një poemë.
 10. Fund tuneli.
 12. Një eleganat si Aramis.
 13. Qe kryeqyteti i Asirisë.
 14. Qe toreador i famshëm.
 15. Urdhëroi sakrifikimin e Ifigjenias.
 16. Eshhtë pushteti i... bashkisë.
 17. Qe lumi i Karontit.
 18. Inicialet e Klee piktor.
 19. Ishte giuha e Jezu Krishtit.
 23. U shndërrua në dre nga Afërdita.
 28. Rex i Nero Wolfe.
 35. Nino, kompozitor i njohur.
 36. Një... story e John Le Carrë.
 38. Shkroi Tregime të jshhtëzakonshme.
 41. Kufizojnë një sektor.
 42. Inicialet e Einstein.
 43. Inicialet e Matthieu, këngëtare.
 44. Kufizojnë sportet.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


1. Lindi Isakun.
3. Në krye të bashkisë.
5. Në djep kur nuk... je.
7. Nota e diapazonit.
9. Emri i parë i Erasmit të Rotterdemit.
12. Mbyllin akte.
14. Filozofi i famshëm me historine e gomarit.
15. Diku në qendër.
16. Rrallë është përgjysmë.
17. Bëri edhe Madame Butterfly.
18. Norman, psikopati te Psycho.
19. Të parat në sjellje.
20. Vret me një re.
21. Gjarpri që u vra nga Apolloni.
24. Lindi Perseun.
26. Besniku mesfushor.
27. Ai i vajimit është në Jerusalem.
29. Carol, aktore.

VERTIKAL


1. Ishte sundimtari i provincave perseisha.
2. Inicialet e Duvall.
3. Qytei i njembinjëdritarve.
4. Ishin armiqtëe babilonasve.
5. Shkroi Jacuqes le fataliste.
6. Eshhtë edhe tendencë.
7. Joan i interpretuar nga Celentano.
8. Jetojnë në vetmi.
9. U soll në Europë në Jean Nicot.
10. Ai i Aida-s është Radames.
11. Një ishte edhe Deceballi.
13. Inicialet e Rohmer regjisor.
18. Titulli i Bruce Springsteen.
20. Hidhet një me... kërcim.
22. U shkrua nga Camus.
23. Fillojnë takimin.
25. Fillojnë natën.
27. Pierce tenisist.
28. Grisur pa gur.
31. Fillojnë panikun.
32. Shijuar pa shuar.
34. Fleming, që krijoi James Bond.
35. Kështu merr ai që... mbaron.
36. Mbatësja e topit në golf.
37. Ekstremer për gotik.
38. Carson i fumnetit-t.
40. Një padi kur s'është ai.
41. Bëhen arianë me një anë.
42. Harris që krijoi Hannibal Lecter (inic).
43. Bëhet nuse me ne.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1	4		5	9				
	2			7				6
		5	1	3	8	4	7	
	8	6	9		5			
		3	2	4			9	
9			3			8	1	
						6	3	
8				3			5	
			6		7			

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	8	9	2	7	5	6	3	4
7	4	6	3	1	8	9	5	2
2	5	3	6	9	4	1	7	8
3	6	4	9	2	7	8	1	5
5	7	8	1	4	3	2	6	9
9	1	2	8	5	6	3	4	7
6	9	7	4	3	2	5	8	1
8	2	5	7	6	1	4	9	3
4	3	1	5	8	9	7	2	6

Argëtim filozofik

-E vërteta mund të jetë atje jashtë, por gënjeshtrat qëndrojnë në kokën tënde.

-Disa njerëz vijnë në jetën tonë, lënë gjurmët e tyre në zemrat tona dhe nuk jemi më kurrë të njëjtë.

-Më e bezdisshme me jetën e përditshme është se ekziston çdo ditë.

-Ai që pi ujë dhe ai që pi ujë, nuk mund të mos mendojnë ndryshe.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm

5	K	1	A	12	3	E		2	1	6	3	10	2	A	Z	O	V	E	T	N	A	B	A	
1	9	1	8				11	1	12		2	3	7	Z	A	G	A	R	R	A	M	B	A	S
3	2	2		13	3	11	1	2	4	2	4			I	C	K	A	L	I	N	I	O	B	I
3	2		13	3	7	3	2	4	5	3				L	C	A	S	Ü	S	B	E	L	L	I
15		5	9	8	4	2	3	2	3	2				T	E	N	T	A	T	I	V	A	T	V
9		3	5	4	11	3	2		2		12			M	A	R	T	I	N	A	E	N	K	E
7	4	5		10	3	2	2	1	11	1				E	T	E	S	E	N	R	O	M	A	N
4		9		15	16			17	2	4	6			T	I	M	E	T	I	P	I	A	F	E
5	1		17	20	4	10	15			17	6			A	M	O	R	F	R	A	T	A	R	
3	9		11	1	2	3	10	2	1	2				L	O	N	Z	E	T	A	F	A	Z	A
	10	1		19	3			18	7	1	2			E	R	I	C	C	E	V	O	N	E	
1	19	8	4			11	4	7	1	2	4			T	E	A	M	A	L	B	A	N	E	T

-Burgjet janë të mbyllura gjatë gjithë ditës, por janë plot, tempujt janë të hapura gjatë gjithë ditës, por ato janë bosh.

-Mos kërkoni lumturinë: është gjithmonë brenda jush.

-Nga të gjithë ata që nuk kanë asgjë për të thënë, më simpatikë janë ata që heshtin.

-I paduruar i zakonisht paguan shumë më shtrejt për ato që i duruar i ka falas.

Thënie të mençura

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

S	E	V	E	N	U	P	S	T	E	F	F	I
A	M	I	N	K	A	P	I	T	A	L	I	
R	I	T	E	T	R	E	L		A	M		
A	L	E	T	F	I	L	O	K	T	E	T	I
H	E	K	A	M	I	K	A	Z	E	K		
K	A	T	A	M	A	R	A	N	I	O	T	
I	R	C	O	L	I	N	R	O	M	Y	S	
T	E	M	A	E	I	B	O	R	I	S		
A	N	I	T	A	E	M	I	L	A	N	O	
R	A	N	V	I	T	M	J	E	R	A	N	
E	T	I	L	E	N	F	R	A	T	T		
B	A	O	B	A	B	P	E	D	A	N	A	T
R	P	E	R	I	P	A	T	E	T	I	K	E
A	P	E	L	P	I	R	A	M	I	D	A	M
V	E	L	P	I	R	A	M	I	D	A	M	
A	R	K	O	L	O	R	T	I	T	L	E	
F	R	O	T	A	G	O	N	I	S	T	E	T
K	A	N	T	A	I	A	T	K	A	T	E	T
A	R	I	E	L	E	T	A	K	A	T	E	T
S	A	L	L	E	T	A	K	U	R	T		
F	R	A	E	S	I	P	I	R	A	T	I	
I	R	A	M	I	B	A	N	O	R	E	T	
K	R	A	T	E	R	E	T	G	J	I	R	I

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

